

THESARE

MJET FRYMËZIMI DHE UDHËRRËFYES PËR PASTORËT DHE SHËRBYESIT

numri 12 / vjeshtë 2017



Editorial 2

Gëzim Spahija

Të Pasqyroni Modelin e Krishtit 3

Almon M. Bartholomew

Nevojiten: Kisha të Shëndetshme dhe Dishepuj të Shëndetshëm 9

LeRoy R. Bartel

Duke Ushtruar

Administrim të Mirë mbi

Martësën dhe Familjen Tuaj 12

Wayde & Rosalyn Goodall

Vetëpërmbytja nga Ankesat: Udhëheqësit Optimistë iu

Shkojnë Gjërave deri në Fund 19

Scott Hagan

10 Karakteristika të një Kise të Shëndetshme 22

Stephen A. Macchia

Të Argëtohem Kur Gjërat Janë Serioze 24

Marcia Lednicky

10 Parimet e Mbjelljes 30

Rick Thomas

Impact Montenegro 2017 34

Kurt D. Plagenhoef

Tema: Pastor i Shëndetshëm, Kishë e Shëndetshme



Tema: Pastor i Shëndetshëm Kishë e Shëndetshme

“Zoti është bariu im, asgjë nuk do të më mungojë”, thuhet tek Psalmi 23. Jezusi është kryebariu, i cili bën që asgjë të mos mungojë për tufën e tij, kishën e tij. Për këtë, ai ka thirrur dhe ka caktuar punëtorët, shërbestarët, pastorët, me qëllim që të kujdesen për grigjën e tij. Çdo pastor, i cili ka marrë thirrjen hyjnore për të ndihmuar në shërbesën frymërore, është thirrur që të marrë mësim në “shkollën e Zotit” përgjatë gjithë jetës së tij. Shërbesa pastorale ofron pa limit mundësi për të mësuar nga Zoti, përmes një jete në bashkësi me Të, në lutje dhe studim e meditim të Fjalës së Tij.

Thirrja është për t’u kujdesur për grigjën, ku Zoti bashkë me thirrjen, i jep pastorit edhe cilësitë për të cilat ai ka nevojë; si për shembull: aftësi, dituri, forcë, dhe durim, për të vigjiluar dhe për të treguar kujdes për shpirtërat. Pastori duhet të marrë nga Zoti një vizion të qartë, që të mund t’i japë kishës drejtimin e duhur, në mënyrë që vizioni i tij të kuptohet dhe të ndiqet me besim dhe respekt nga të gjithë besimtarët.

Tre janë elementët të cilët bëjnë që shërbesa e një pastori të shëndetshëm të ketë ndikim në kishën e tij: kur ai punon me përkushtim për ndreqjen e shenjtoreve, për veprën e shërbimit, dhe për ndërtimin e trupit të Krishtit. Kjo reflektohet në një kishë të shëndetshme,

derisa të arrijmë të gjithë tek uniteti i besimit dhe i njohjes së Birit të Perëndisë. Për këtë, atij i duhet të jetë efektiv dhe të marrë fryte në shërbesën e tij, duke bashkëpunuar dhe duke u mbështetur krejtësisht tek Fryma e Shenjtë. Kjo arrihet duke ia nënshtruar çdo aftësi apo zgjuarsis njerëzore drejtimit të Frymës së Shenjtë, në mënyrë që besimtarët të kuptojnë se bekimet e tyre kanë origjinë hyjnore. Jeta praktike e tij duhet të jetë zbatimi i Fjalës së Zotit të cilën ai e predikon, duke dëshiruar të mbajë të freskët vajosjen e tij nga lart.

Një kishë e shëndetshme duhet që në çdo situatë të ruajë unitetin e Frymës, duke pasur paqe e siguri të plotë nën autoritetin e Krishtit, që është kreu i kishës. Për ta realizuar këtë, pastori duhet të ketë besim si të Abrahamit, butësi si të Moisiut, aftësi si të Davidit, dituri si të Salomonit, guxim si të Elias, durim si të Jobit dhe forcë frymërore si të Palit, për të kryer një shërbesë të shëndetshme për një kishë të shëndetshme.



GËZIM SPAHIJA, Drejtor Ekzekutiv,
Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve
të Perëndisë të Shqipërisë.

THESARE

Numri 12
Vjeshtë 2017

Koordinatorë e projektit: Stephanie Plagenhoef
Përkthyes: Fabian Tozharaku
Redaktues: Skënder Hoxha
Grafika kompjuterike: Lindita Sqapi

Botuar nga:
Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë
të Shqipërisë

Në bashkëpunim me:
Life Publishers International

Adresa: K.P. 119 / Kutia 2 / Tirana, Albania
Cel: (+355) 69-406-8956
Email: KTU@icc-al.org



Artikujt e zgjedhur dhe grafika përshtatur nga revista Enrichment - ©Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë, ShBA. Përdorur me leje.

©Life Publishers International. Të gjitha të drejtat të rezervuara.



TË PASQYRONI Modelin e Krishtit

Nga: ALMON M. BARTHOLOMEW

Shenjat jetike të jetës frymërore, si brenda jetës së pastorit, ashtu edhe

të kishës, duhet të përfshijnë qartësinë me të cilën pasqyrohet në

mënyrë të çiltër ngjashmëria me Zotin tonë.

Në kapitullin e parë të Zanafillës, pemët, bari dhe çdo krijesë tjetër që lëvizte në qiell, në tokë dhe në det riprodhohej secili sipas llojit të vet. Plani hyjnor është që çdo brez i shëndetshëm t'i japë jetë të shëndetshme secilit brez pasardhës.

Po kështu, të njëjtin parim mishëron edhe tema: "pastor i shëndetshëm - kishë e shëndetshme". Ekziston një lidhje reciproke midis një pastori të shëndetshëm dhe një kishë të shëndetshme. Në qoftë se parimi "secili prodhon sipas llojit të vet" është jetik, atëherë merrni parasysh potencialin që ky parim mbart për kishën e sotme dhe të nesërme.

Ky artikull përqendrohet tek një aspekt i kësaj teme: Një pastor i shëndetshëm është dikush që është i ngjashëm me Krishtin. Modeli ynë i patëmetë është Jezu Krishti, Bari i Madh i deleve (kishës së Tij). Është e domosdoshme që imazhi i projektuar nga ky model të jetë lehtësisht i identifikueshëm tek pastori, i cili është një nënbari i tufës së Perëndisë. Shprehja tipike e atij imazhi të udhëheqjes do të ketë një ndikim të madh në jetën personale dhe në jetën e përbashkët të kishës. Mungesa e këtij imazhi e shpërftyron dhe e shkatërron qëllimin që Krishti kishte për trupin e Tij. Shenjat e domosdoshme të jetës frymërore, si brenda jetës së pastorit, ashtu edhe asaj të kishës, duhet të përfshijnë qartësinë me të cilën pasqyrohet në mënyrë të çiltër ngjashmëria me Zotin tonë. Ky reflektim kërkon një derdhje të trefishtë të kallëpit:

ZHVILLIMI I BRENDSHËM

Do të duhet më shumë sesa një përvojë e cekët apo sipërfaqësore për t'i bërë parimet e Krishtit pjesë të natyrës sonë. Përftimi dhe zhvillimi i këtyre parimeve vjen si rrjedhojë e praktikimit të intimitetit me Perëndinë. Gjithmonë më ka ngjallur kureshtje dhe mbresa titulli i librit të Tomas a Kempis "Imitimi i Krishtit" (*Imitation of Christ*). Teksti, i cili u shkrua nga një prift i lindur në Gjermani në shekullin e 15-të, ka

pasur një ndikim shumë të madh në botën e krishterë, veçanërisht tek udhëheqësit e Reformimit, duke përfshirë edhe Martin Luterin. Themeli i tij biblik i parimit të dashurisë hyjnore, i rrënjësuar thellë në natyrën e Perëndisë, kthehet në forcën e pareshtur motivuese të jetës së krishterë. Çdo nivel i funksionit njerëzor shenjtërohet nga ky hir i veçantë. Jeta e Krishtit përsëdytet (apo përsëritet edhe një herë) në jetën e shërbëtorëve të Tij.

Kjo lloj vërtetësie sot është shumë e nevojshme në shërbesë. Ajo përftohet duke e përthithur dhe duke e përvetësuar (asimiluar) Fjalën e Perëndisë. Rritja e saj shtohet përmes kohës që kalohet në praninë e Tij. Dhe ndërkohë që e ndjekim Krishtin hap pas hapi, ajo merr imazhin e Tij.

Këshilla e apostullit Pjetër është themelore ndaj këtij orientimi. Tek kapitulli i parë i letrës së tij të dytë, ai i inkurajon lexuesit e tij për të pasur jetë të vërteta dhe përvetësimi që arrihen përmes fuqisë së Perëndisë duke nxjerrë në pah një jetë të lavdishme dhe të virtytshme. Nëpërmjet premtimeve "të mëdha e të çmueshme" të Perëndisë, ne bëhemi "pjesëtarë të natyrës hyjnore" të Krishtit (vargu 4). Në proces e sipër ne përfitojmë imunitet nga fuqia prishëse e një bote të ngarkuar me eposh.

Mbreti David tha: "E kam ruajtur fjalën tënde në zemrën time, që të mos mëkatoj kundër teje" (Psalmi 119:11). Njeriu i bekuar i Perëndisë tek Psalmi i parë, i cili lulëzon si një pemë e mbjellë buzë ujit, kënaqet dhe mediton ditë e natë në Fjalën e Perëndisë.

Kur Ezekieli u ngarkua për të profetizuar, atij iu dha një rrotull nga Shkrimi dhe u urdhërua që ta gëlltiste. Ja se si e tregon ai: "Pastaj më tha: 'O bir njeriu, ushqej barkun tënd dhe mbushi zorrët e tua me këtë rrotull që po të jap'. Kështu unë e hëngra dhe u bë në gojën time i ëmbël si mjaltë. Më tha akoma: 'O bir njeriu, nis, shko në shtëpinë e Izraelit, u trego atyre fjalët e mia' " (Ezekieli 3:3,4). Kur Perëndia jep si një "recetë", Fjalën e Tij për shërimin e shpirtit, mos pranoni një zëvendësues të përgjithshëm.

Shenjat e jashtme të mikpritjes, vetëkontrollit (disiplinës së vetvetes),

përrulësisë, dhe predikimit të doktrinë së shëndoshë ua modelojnë

dishepullizimin njerëzve që marrin mesazhin e Perëndisë.

Tek Gjoni 17, Jezusi i shpalli dishepujt e Tij të pastër përmes Fjalës që ai u kishte folur atyre. Më tej, ai tha: “Fjala jote është e vërteta”. Koha intime (e ngushtë) që këta burra kaluan duke e dëgjuar Atë të jepte mësim, duke e parë Atë të ecte në mesin e një morie njerëzish të ndryshëm dhe të kishte sukses në shërbesë, u la atyre një vulë të pashlyeshme. Nuk ka rrugë të shkurtër për t’u bërë si Jezusi. Të njëjtat disiplina që iu dhanë formë jetëve të dishepujve të parë duhet të vihen në përdorim edhe sot tek shërbëtorët e Krishtit.

Identiteti ynë në Krishtin rritet ndërsa kalojmë më shumë kohë në praninë e Tij. Dymbëdhjetë dishepujt shpenzuan 3 vjet në takime të përditshme. Ata vëzhguan jetën e Tij të lutjes. Ata ishin dëshmitarë të veprave të Tij të fuqishme. Ata dëgjuan predikimin e Tij dinamik dhe mësimdhënien e Tij të pashoqe. Ata mësuuan nga shembulli i Tij në jetë, aftësitë e Tij në ndërveprim me njerëzit, qoftë kur ishte mes miqsh apo armiqsh. Ata u ushqyen me vlerat e Tij. Kjo ishte një marrëdhënie e ngushtë, tërheqëse dhe jetë-ndryshuese.

Sot nuk e kemi privilegjin që të ecim në praninë e Tij të dukshme. Megjithatë, kemi në dispozicion praninë e Frymës së Shenjtë, i cili merr gjërat e Krishtit dhe na i tregon. Ai ka ardhur për ta na e bërë Krishtin të njohur. Këtë proces, apostulli Pal e ka ngërthyer tek 2 Korintasve 3:18: “Por ne të gjithë, duke soditur fytyrëzbuluar lavdinë e Zotit si në pasqyrë, shndërrohemi në të njëjtin shëmbëllim nga lavdia në lavdi”. Krishti po formohet përbrenda nesh. Bibla e bën të qartë se jo vetëm që do të mbartim imazhin e Krishtit në jetën tjetër, por duhet të mbartim imazhin e Tij edhe në botën tonë të sotme: “Dhe sikurse mbartëm shëmbëllimin e tokësorit, do të mbartim edhe shëmbëllimin e qiellit”. (1 Korintasve 15:49)

DEMONSTRIMI I JASHTËM

Zhvillimi i brendshëm dhe frymëror i pastorit të shëndetshëm do të reflektohet së jashtmi. Kjo nasjell në pikën e demonstrimit të jashtëm të ngjashmërisë me Krishtin, e cila është diçka thelbësore për një shërbesë efikase. Krishti duhet të shihet në çdo shtresë të jetës së dikujt. Ne kemi nevojë për më shumë sesa një qëndisje të zbukuruar me vello. Shkrimi është i qartë: “Sepse, ashtu si mendon në zemër të tij, ashtu është ai”. (Fjalët e Urta 23:7).

Po ashtu edhe Jezusi kishte një dy fjalë rreth shprehjeve të zemrës: “Sepse, ç’ka zemra, qet goja”. (Mat. 12:34). Më tej, ai tha: “Sepse nga zemra dalin mendimet e mbrapshta, vrasjet, shkeljet e kurorës, kurvëria, vjedhjet, dëshmitë e rreme, blasfemitë”. (Mat.15:19). Mbajtja e zemrës të shëndetshme është një kusht paraprak për një shërbesë të shëndetshme e cila do të prodhojë një kishë të shëndetshme.

Cilat janë ato tipare të rrënjësura të karakterit të Jezusit të cilat janë kaq të dukshme, dhe aq të domosdoshme tek ne, të cilët kemi marrë thirrjen e Tij? Fryti i Frymës i renditur nga apostulli Pal duhet patjetër të numërohet në mesin e tyre. Tek lista e Gal.5:22 përfshihen: “dashuria, gëzimi, paqja, zemërgjerësia, mirëdashja, mirësia, besimi, zemërbutësia, vetëpërmbytja”.

Tek kapitulli 5 i Letrës së tij të Parë, Pjetri nxit pleqtë e kishës që të jenë barinj të vërtetë dhe kujdestarë të tufës së Perëndisë. Ky shërbim nuk duhet të merret përsipër si ndonjë angari apo detyrë pa gëzim, por me gatishmëri. Ajo duhet të bëhet me një lloj vetëdije të mprehtë që ne dëshirojmë të kënaqim Perëndinë, duke qenë se është Ai që na ka thirrur. Nuk ka vend për lakmi apo materializëm. Por duhet të shërbejmë me energji, dhe jo duke pasur zotërim mbi tufën e Perëndisë. Ai na kujton se dita e shpagimit do të vijë kur të shfaqet Jezusi.

Si apostulli Pal, ashtu edhe Jakobi, i krahasojnë shërbëtorët e Perëndisë si “bujq që mundohen”. Letra e dytë drejtuar Timoteut 2:6, na tregon se ky bujk i zellshëm duhet të marrë i pari pjesën e të korrave. Ndërkohë që kjo nënkupton përfitim nga të korrat, po ashtu sugjeron se ai duhet të ketë pjesë nga i njëjti ushqim frymëror që i ushqehet tufës së tij. Tek referenca nga Jakobi, bujkut i bëhet thirrje të tregojë durim derisa të mbjellat të kenë arritur pjekjen. Mësimet që nxirren nga të dyja pasazhet shfaqin sjelljen (administrimin) e bujkut që mundohet në arë.

Pali kishte një kundërhelm të fuqishëm për trajtimin e personave grindavecë e kundërshtues. Shpeshherë shërbëtarët sillen me njerëzit në të njëjtin nivel dhe me të njëjtën natyrë hakmarrëse që u është treguar edhe atyre. Ky përshkallëzim i sjelljes do ta shkatërrojë veprën e Perëndisë. Në këto situata, Pali përshkruan një ilaç të mirë e parandalues për atë që do të jetë një pastor i shëndetshëm. “Sepse shërbëtori i Zotit nuk duhet të grindet, por duhet të jetë i butë me të gjithë, i aftë për të mësuar të tjerët dhe që duron të keqen, duke i mësuar me zemërbutësi kundërshtarët, me shpresë se Perëndia ua jep atyre të pendohen, që të njohin të vërtetën, dhe të vijnë në vete, jashtë nga laku i djallit, që i ka zënë robër për vullnetin e tij”. (2 Timoteut 2:24-26).

Pali, ndërsa i shkruan Titit, e vazhdon udhëzimin e tij: “Sepse peshkopi, si administrues i shtëpisë së Perëndisë, duhet të jetë i paqortueshëm, jo arrogant, jo zemërak, jo i dhënë pas verës, jo i dhunshëm, jo njeri që lakmon fitim të turpshëm”. (Titit 1:7).

Secili nga apostujt e vë theksin tek durimi në kohë vuajtjesh, humbjesh dhe vështirësish. Shenjat e jashtme të mikpritjes, vetëkontrollit (disiplinimit të vetes), përlësisë, dhe predikimit të doktrinës së shëndoshë ua modelojnë dishepullizimin njerëzve që marrin mesazhin e Perëndisë. Këto gjëra e bëjnë ungjillin që të kumbojë i vërtetë.

Letrat pastorale (Letrat e Palit drejtuar pastorëve, Timoteut dhe Titit) janë plot e përplot me udhëzime të shëndosha për shërbëtorin e Perëndisë, i cili do ta demonstrojë me besnikëri dhe efikasitet këtë lloj besimi. Në rast se nuk e jetojmë vetë ungjillin, nuk kemi për të bërë dishepuj. Pali e kuptoi këtë kur i shkroi Timoteut dhe i tha: “Por ti ndoqe mësimin tim, sjelljen, qëllimin, besimin, zemërgjerësinë, dashurinë, durimin”. (2 Timoteut 3:10).

A EKZISTON NJË LIDHJE RECIPROKE MIDIS NJË PASTORI TË SHËNDETSHËM DHE NJË KISHE TË SHËNDETSHME?

Ekziston një lidhje e qartë midis asaj që një pastor merr nga burimet nga të cilat mbushet dhe shërbesës që rrjedh prej tij drejt bashkësisë së tij. Ajo me të cilën ai është mbushur është ajo që ai nxjerr. Stenli Kohen (Stanley Cohen), një profesor në kolegjin shtetëror të Glassborout në Nju Xhersi, në lëndën e tij me titull “Themelet Psikologjike të Arsimit”, tha: “Është e pamundur që të përcjellim informacion pa përcjellë edhe vlera”. Ia vlen të reflektojmë mbi këtë deklaratë. Një shërbëtar nuk mëson, predikon apo administron në zbrazëti. Çfarë hyn nga porta hyrëse, duke kaluar përmes personit të pastorit, do të kalojë gjithashtu edhe nga porta dalëse. Njerëzit që janë nën përgjegjësinë e tij do të jenë marrësit e kësaj shërbesë, qoftë ajo e paprishur apo e kalbur. Shëndeti i kishës vendore varet tërësisht tek shëndeti frymëror dhe burimet e pastorit të saj. Dëshmitë që e vërtetojnë këtë janë të panumërta.



Ne ishim të bekuar që kishim tre pastorë në kishën tonë gjatë 37 viteve që përfshinin vitet e rritjes dhe procesin e pjekjes në fillim të shërbesës sonë. Secili prej tyre kishte një ndikim shumë të madh e pozitiv tek ne. Askush nuk kishte qoftë edhe një hije skandali apo kompromisi. Ata ishin nxënës të shkëlqyer të Fjalës dhe na mësuam shumë mirë. Ata e kishin mendjen tek gjërat frymërore dhe e përçuan edhe tek ne këtë mendësi. Ata ishin të talentuar me aftësi për trajtimin e njerëzve dhe ishin administratorë të zotë të kishës. Përtej gjithë kësaj, ndërsa modelonin shërbesën tek ne, ata ishin të përlur në mënyrë shumë të çiltër. Asnjëri prej tyre nuk dukej i vetëdijshëm për thellësinë që shërbesat dhe vetë ata si njerëz kishin sjellë tek ne. Gjatë asaj periudhe, më shumë se 15 të rinj e të reja u thirrën në shërbesë dhe iu përkushtuan shërbesës me kohë të plotë. Pastorë të shëndetshëm prodhuan një kishë të shëndetshme.

***Almon M. Bartholomew,
Kuinsbëri, Nju Jork***



DINAMIKAT E PËRJETSHME

Pasi e kemi bërë besimin, pjesë të zhvillimit tonë frymëror dhe pasi e kemi demonstruar besimin së jashtmi tek bota, shërbesa jonë duhet gjithashtu që të posedojë një dinamikë të përjetshme. Fjala “dinamikë” është përdorur qëllimisht. Besimi ynë nuk është një besim pasiv, i cili është i kyçur në inercinë e traditës. Ai është i gjallë, lëviz dhe arrin njerëz.

Kjo dinamikë ishte në punë e sipër edhe tek libri i Veprave të Apostujve. Mbretëria u rrit nga 120 vetë, në 3 mijë, në 5 mijë, në mori njerëzish, që nga kryeqyteti i judaizmit e deri në kryeqytetin e Perandorisë Romake dhe në botën e njohur në atë kohë, në vetëm një shekull të shkurtër. Dhe kjo u arrit pa sistemet e teknologjisë së lartë me të cilat jemi të mësuar sot. Shërbëtorët e Perëndisë kishin një rrugëtim intim me Perëndinë i cili e demonstronte veten së jashtmi dhe i dha formë fatit të miliona njerëzve, përfshirë këtu edhe ata që iu shtuan mbretërisë në shekujt që kalonin.

Kisha kaloi nëpër një periudhë kohore që njihet me emrin Shekujt e Errët (Periudha Fillestare e Mesjetës). Gjatë kësaj kohe, Kisha përjetoj një shëndet të dobësuar nga ana frymërore. Shëndeti frymëror filloi t'i rikthehej Kishës në mbarë botën gjatë Reformacionit dhe në lëvizjet dinamike të ripërtëritjes dhe rizgjimit që e pasuan atë. Kykthim i shëndetit hapi rrugën për miliona njerëz që të përfshiheshin në Mbretëri ndërkohë që ungjilli e rrethoi gjithë globin. Në qoftë se duam të shohim këtë grumbullim shpengues që të fryhet e të rritet, atëherë është e domosdoshme që kisha të përjetojë një shëndet frymëror kumbues. Dhe çelësi për ta përmbushur këtë mision janë shërbëtarët e shëndetshëm të ungjillit.

Ndërsa fokusohemi tek cilësia e përjetshme e kësaj dinamike, ajo do të na çojë drejt efikasitetit të qëndrueshëm të ungjillit dhe të lajmëtarëve të tij. Tek Gjoni 15, Jezusi i këshilloi ndjekësit e Tij se i kishte vajosur për të sjellë në jetë fryte, dhe që ky fryt duhet të zgjaste.

Në një tjetër metaforë tek 1 Korintasve 3, Pali i krahason shërbëtorët e Perëndisë me ndërtues të zgjuar. Ai gjithashtu na thotë se jemi “bashkëpunëtorë të Perëndisë”. Ai thekson rëndësinë që ka ndërtimi i një strukture të jashtëzakonshme që është e denjë për themelin që është hedhur tashmë, pra, Jezu Krishti. Kjo Kishë po ndërtohet për të qëndruar për gjithë përjetësinë.

N

NUK KA RRUGË TË SHKURTËR PËR T'U BËRË SI KRISHTI

Nuk ka rrugë të shkurtër për t'u bërë si Krishti. Ndërkohë që ishim në Nju Xhersi në vitet '60, përcollëm nga kjo botë 27 anëtarë të moshuar të kishës. Këta ishin shenjtorë që jepnin të dhjetën, luteshin, kishin dhembshuri, ishin të përkushtuar dhe të pjekur. Si shumë pastore të tjerë në këtë situatë, edhe unë e ngrita zërin përpara Zotit për t'u ankuar. "Këta janë nga njerëzit më të mirë në kishë. Do të më marrë shumë malli për ta". Pastaj e pyeta: "O Zot, përse janë kaq të vështirë për t'u zëvendësuar ata?"

Ai u duk se i foli zemrës sime dhe tha: "Duhet një kohë e gjatë për të rritur njerëz të tillë".

Jetojmë në një epokë ku gjithçka është e menjëhershme. Jemi thirrur për të qenë shenjtorë, por ky proces nuk ndodh sa hap e mbyll sytë.

Gjeneralit William Booth, themelues i organizatës Ushtria e Shpëtimit (Salvation Army), i atribuohet kjo thënie: "Është në natyrën e zjarrit që të bëjë gjithçka që prek, si veten e vet". Autori i Hebrejve na kujton se 'Perëndia ynë është një zjarr që konsumon!'. Si pasto-rë, ne duhet të jemi në kontakt me zjarrin e pranisë së Tij dhe t'i japim Atij të gjithë kohën e nevojshme për të na bërë edhe ne si Ai.

Edhe një tjetër metaforë i përshtatet mirë kësaj ideje. Askush nuk duhet t'i thotë ujit të kripur se çfarë duhet të bëjë. Gjatë procesit të bërjes së turshive, kastravecët zhyten në ujin e kripur bashkë me erëza të tjera. Në kohën e caktuar,

efekti i ujit të kripur e kryen punën e vet. Në mënyrë mahnitëse, kastravecët bëhen turshi. Megjithatë, askush nuk i fut kastravecët në ujin e kripur në darkë dhe pret që të marrë turshi në mëngjes. Procesi duhet të përfundojë. Sa nevojë që kemi edhe ne që të "regjemi" në praninë e Perëndisë. Nuk ka rrugë të shkurtër përgjatë rrugëtimit tonë për t'u bërë si Krishti.

Almon M. Bartholomew,
Kuinsbëri, Nju Jork

Nuk mund t'ia lejojmë vetes të jemi të dobët në mjeshtërinë tonë. Në fakt, Pali tha se e gjitha do t'i nënshtrohet provës së zjarrit. Në rast se materialet tona janë "dru, sanë, kashtë", ato do të konsumohen. Vetëm "ari, argjendi, gurë të çmuar" do të rezistojnë. Pastorët kanë nevojë për një pamje të shëndet-shme të pasojave të përjetshme të punës së tyre. Nuk është e lehtë të përmirësohemi mbi vargun e kësaj poeme që thotë: "Vetëm një jetë, që shpejt do të kalojë; vetëm çka është bërë për Krishtin do të rezistojë".

Si mund të llogaritet kjo dinamikë tani për përjetësinë? Jezusi na dërgoi që të shkojmë në mbarë botën dhe t'ia predikojmë ungjillin çdo krijesë. Ai na udhëzoi shumë qartë që këta të konvertuar t'i kthejmë në dishepuj. Apostulli Pal ia parashtrori shumë mirë Timoteut: "Ti, pra, biri im, forcohu në hirin që është në Krishtin Jezus; dhe ato që dëgjoje nga unë përpara shumë dëshmitarëve, besojua njerëzve besnikë, që do të jenë të aftë të mësojnë edhe të tjerë" (2 Timoteut 2:1,2). Duhet të ketë një vazhdimësi nga njëri brez tek tjetri. Dhe kjo është natyra e dinamikës së përjetshme.

Mjeku i Madh është i pranishëm për të sjellë shërim. Le t'i sjellim jetët tona tek Ai për një kontroll të imtësishëm. Tek Jeremia 8:21, 22, profeti që derdhte lot i bashkohet vajtimin të Perëndisë: "Për plagën e bijës së popullit tim jam i dëshpëruar, po mbaj zi, jam i tmerruar. A nuk ka vallë ndonjë balsam në Galaad, a nuk ka atje ndonjë mjek? Pse, pra, nuk po i vjen shërimi bijës së popullit tim?"

Pastorët janë mjekët e shpirtit. Është e domosdoshme që ne, si pastore, të kemi shëndet të fortë frymëror në qoftë se dëshirojmë t'i përgjigjemi përgjërimit që gjendet tek Jeremia. Çelësi për një kishë të shëndetshme është një pastor i shëndetshëm.



ALMON M. BARTHOLOMEW,
është një ish drejtues ekzekutiv
i Asambleve të Perëndisë dhe
jeton në Kuinsbëri, Nju Jork.

Nevojiten: **Kisha të Shëndetshme dhe Dishepuj të Shëndetshëm**

Nga: **LEROY R. BARTEL**

Të gjithë duan të jenë pjesë e një kisha të shëndetshme, efikase dhe në rritje. Kishat e shëndetshme janë kisha që janë duke u rritur. Për këto kisha, rritja nuk është një program. Është rezultat i një dinamike të natyrshme jetese brenda trupit të Krishtit, e cila është sjellë në jetë nga Perëndia, por gjithashtu është ushqyer nga udhëheqësit e kishës.

Kisha nuk duhet ta kryejë kurrë shërbesën e saj mbi bazat e hamendësimeve apo ndjenjave të çastit. Ajo nuk duhet të çmojë risinë apo inovacionin e pavarur. Një kishë nuk duhet të përpiket të krijojë një vetë-perceptim për veten e saj pa u këshilluar me mësimet e qarta të Shkrimit. Shërbesa, programet dhe strategjia e kishës vendore duhet që të gjitha të nxiten përpara nga qëllime biblike.

Bashkësitë e shëndetshme punojnë fort për të bërë dishepuj brenda një konteksti ku të gjitha qëllimet biblike gjejnë pasqyrimin e duhur.

Çfarë është një kishë e shëndetshme? Është ajo kishë në të cilën të gjitha qëllimet biblike gjejnë pasqyrim në një ekuilibër të përshtatshëm.

Kishat e shëndetshme e riprodhojnë veten e tyre. Kishat e shëndetshme prodhojnë të krishterë të shëndetshëm. Dhe, bashkësitë e shëndetshme punojnë fort për të bërë dishepuj brenda një konteksti ku të gjitha qëllimet biblike gjejnë pasqyrimin e duhur (Efe. 4:14-16; Kol. 1:10-12).

Cilat janë qëllimet biblike që gjejnë pasqyrim në një kishë të shëndetshme?

1. Miqësia – Anëtarësia

Kuptimi bazë i fjalës greke *koinonia* që është përkthyer “miqësi” (ose bashkësi) në Biblat tona nënkupton pjesëmarrje. Kjo fjalë përdoret për të shprehur marrëdhëniet e lidhura ngushtë që ekzistojnë brenda anëtarësisë së mbushur me Frymë të trupit të Krishtit, pra, kishës.

Veprat e Apostujve 2:42-46 shprehin me terma entuziaste se çfarë do të thoshte për kishën e parë miqësia që prodhohej nga Fryma. Ky ishte konteksti në të cilin njerëzit mësonin jetën e krishterë. Kjo ishte dinamika që karakterizonte festimet e tyre të Darkës së Zotit, vaktet e miqësisë dhe takimet e lutjes. Ajo prodhoi një qëndrim të përbashkët dhe reciprok të altruizmit dhe zemërgjerësisë brenda kishës. Për ta, miqësia nuk kufizohej në një ditë të vetme të javës, por i karakterizonte dhe kaliste të gjitha marrëdhëniet e tyre. Miqësia e pasuroi adhurimin e tyre dhe siguroi kontekstin e ngrohtë dhe dashamirës, gjëra të cilat tërhoqën njerëz të ndryshëm, dhe përmes tyre, këta njerëz zbuluan Krishtin (Gjoni 13:34, 35). Miqësia e kishës së parë nuk ishte një atmosferë verbërisht tolerante dhe e lejueshme. Letra e Parë e Gjoni 1:6, 7 tregon qartë se ajo karakterizohej nga dashuria e rreptë, e vërteta dhe nga dishepullizimi praktik. Kjo miqësi kërkonte pajtim dhe interesim reciprok. Miqësia (bashkësia) nuk është kurrë e lehtë; nuk vjen kurrë aksidentalisht; dhe gjithmonë kërkon përpjekje (Efesianëve 4:3).

Miqësia ndërmjet anëtarëve të saj ka qenë gjithmonë thelbësorja që e ka karakterizuar kishën. Qëllimi është që të pakonvertuarit të bëhen anëtarë të familjes së Perëndisë përmes lindjes së re. Qëllimi për njerëzit që e njohin Krishtin është që ata të bëhen anëtarë pjesëmarrës dhe në rritje të një bashkësie vendore.

2. Dishepullizimi - Pjekuria

Nuk mjafton vetëm që njerëzit të vijnë në njohjen që Krishti është shpëtimtari i tyre personal. Jezusi i thërret ata drejt dishepullizimit (Luka 9:23, 24). Kisha duhet të bëjë gjithçka për t'i ndihmuar të krishterët e rinj që të zhvillojnë ato zakone të jetës që do të garantojnë rritjen dhe fitoren e tyre frymërore (leximin dhe studimin e Biblës, pjesëmarrjen në kishë, lutjen, administrimin financiar, etj.). Ata duhet të përvetësojnë një njohuri praktike të Biblës dhe të doktrinës bazë të krishterë. Çdo besimtar duhet të jetë i përfshirë, brenda një grupi miqsh, në atë lloj studimi sistematik të Biblës siç ofrohet nga shkolla e së dielës. Besimtarët duhet të përvetësojnë njohurinë

që ka vlerë më shumë, pra, njohurinë e Perëndisë, në masa gjithnjë e më të mëdha (Filipianëve 3:7-11; Kolosianëve 1:9-11).

Kisha vendore sot duhet të jetë po aq e qëllimshme dhe serioze në reagimin e saj ndaj mandatit të mësimdhënies (Mateu 28:18-20), sa ishte edhe kisha e parë. Me të njëjtin seriozitet që predikonin, ata gjithashtu edhe jepnin mësim. Ata nuk i linin besimtarët e rinj që, brenda disa javëve, të hynin e të dilnin pa u vënë re. Ata e vëzhgonin nga afër zhvillimin e tyre frymëror. Dishepullizimi nuk ishte diçka që mund të bëhej me zgjedhje. Çdo diskutim për konvertim pa dishepullizim do të kishte qenë i papajtueshëm dhe i paarsyeshëm për ata. Dishepullizimi i përfshinte të gjitha moshat, grupet dhe statet e zhvillimit frymëror (2 Timoteut 3:14-16). Bërja e dishepujeve i përfshinte të gjithë dhe vazhdonte "derisa të arrijmë të gjithë tek uniteti i besimit dhe i njohjes së Birit të Perëndisë, te një burrë i përsosur, në masën e moshës së plotësisë së Krishtit". (Efesianëve 4:13).

3. Shërbimi - Shërbesa

Jezusi i mësoi dishepujt e Tij se kuptimi do të gjendej duke shërbyer. Kur dishepujt shfaqën frymën e konkurrencës, Jezusi insistoi se madhështia në mbretërinë e Tij nuk do të gjendej tek pozita, por tek shërbimi (Mateu 20:20-28). Fjala që shpesh përkthehet "shërbesë" në Dhjatën e Re nuk ka kryerjen publike të punëve në kishë si kuptimin themelor të saj, por shërbimin e përlur, siç është shërbimi në tryezë. Pak para vdekjes së Tij, Jezusi ofroi një shfaqje supreme të kuptimit të shërbimit, duke iu larë këmbët dishepujeve të Tij. Pastaj, u tha dishepujeve: "Në qoftë se unë, pra, Zoti dhe Mësuesi, ju lava këmbët juve, edhe ju duhet t'ia lani këmbët njëri-tjetrit" (Gjoni 13:14). Dishepullizimi nuk mund të jetë kurrë i plotësuar, derisa njerëzit të jenë të përfshirë në shërbim.

Dhjata e Re na mëson qartësisht se çdo besimtar ka dhunti dhe aftësi të dhëna prej Perëndisë (Mateu 25:14-30; Romakëve 12:6; 1 Korintasve 12:4-7; 1 e Pjetrit 4:10). Sipas Efesianëve 4:11-16, një nga përgjegjësitë kyçe të udhëheqjes së kishës është që të ndihmojë besimtarët të zbulojnë dhe të identifikojnë aftësitë dhe dhuntitë që Perëndia u ka dhënë, dhe më pas t'i ndihmojë ata që t'i zhvillojnë dhe t'i përdorin ato në shërbesë. Kisha ka një përgjegjësi për të ndihmuar me identifikimin e dhuntive, trajnimin dhe gjetjen e vendit në shërbesë. Megjithatë, secili besimtar, ka një përgjegjësi personale për të zhvilluar dhe përdorur vazhdimisht dhuntitë e Perëndisë për përfitimin e të tjerëve dhe

për mirëqenien e kishës (Romakëve 12:6-8; 1 Korintasve 12:7, 14-27; 1 e Pjetrit 4:10, 11). Kur kjo ndodh, përfiton e gjithë kisha. Ka unitet, bekim dhe rritje, dhe në fakt, kisha gjithnjë e më shumë bëhet ajo që Perëndia dëshiron që ajo të jetë (Efesianëve 4:12-16).

4. Ungjillëzimi - Misioni

Ungjillëzimi është vlerësuar gjithmonë si një qëllim kryesor brenda kishës pentekostale. Ky është qëllimi mbi të cilin janë bazuar të gjitha qëllimet e tjera për kishën. Që prej fillimit është dukur se çdo besimtar i pagëzuar me Frymën e Shenjtë e ka parë veten si një predikues. Duket sikur puna e Frymës në jetën e besimtarit e ka shprehur veten në mënyrë të pashmangshme përmes zjarrit të ungjillëzimit.

Kisha duhet të bëjë gjithçka për t'i ndihmuar të krishterët e rinj që të zhvillojnë ato zakone të jetës që do të garantojnë rritjen dhe fitoren e tyre frymërore.

Qëllimi ungjillëzues i Kishës është rrjedhoja e drejtpërdrejtë e Porosisë së Madhe që u dha nga Jezusi (Mateu 28:18-20; Marku 16:15-20; Luka 24:46-49; Gjoni 20:21, 22). Ungjillëzimi është i rrënjësor tek ungjilli, pra tek historia e mahnitshme e Jezusit (jeta, vdekja, varrimi, ringjallja e Tij dhe ngritja për t'u ulur në krahun e djathtë të Perëndisë). Ajo është historia e Krishtit i cili "erdhi të kërkojë dhe të shpëtojë atë që kishte humbur" (Luka 19:10).

Fuqizimi i Frymës së Shenjtë është në radhë të parë dhe mbi të gjitha një fuqizim për të dhënë dëshmi efikase (Veprat e Apostujve 1:4, 5, 8). Libri i Veprave të Apostujve tek Dhjata e Re është regjistrimi emocionues dhe i jashtëzakonshëm i ungjillëzimit me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë nga ana e kishës së hershme. Përvoja pentekostale është po aq thelbësore sot për ungjillëzim efikas sa ç'ishte edhe në shekullin e parë.

Porosia e Madhe, e ushqyer nga pasioni pentekostal, ka rezultuar në sipërmarrje dhe pasion misionar në mbarë botën. Kishat Pentekostale kanë qenë gjithmonë kisha misionare. Pavarësisht nga moshë apo nga thirrja, besimtarët duhet të drejtohen drejt një ndërgjegjësimi misionar. Ata duhet të inkurajohen që ta konsiderojnë në lutje rolin që mund të kenë në misionin për ta çuar ungjillin deri në skajet e dheut (2 Korintasve 5:14-21).

5. Adhurimi - Madhështimi

Një nga qëllimet kryesore të kishave pentekostale është adhurimi. Pentekostalët besojnë se jo vetëm që Perëndia duhet të adhurohet për shkak të Atij që është (d.m.th. karakteri i Tij i shfaqur, sipas të vërtetës), por gjithashtu me një frymë të motivuar dhe të drejtuar nga Fryma e Shenjtë (Gjoni 4:19-24). Për ta, kjo është më e rëndësishme sesa vendndodhja, pozicioni fizik, praktikat fikse, formula apo liturgjia fetare apo oraret e caktuara (d.m.th. kalendari fetar).

Takimet tona të adhurimit duhet të jenë të përqendruara tek Krishti, dhe pavarësisht natyrës së rastit, ato duhet të jenë të karakterizuara nga një vetëdije dhe pranim i pranisë së Perëndisë në mesin e popullit të Tij (Mateu 18:20; 1 Korintasve 5:4). Në adhurimin pentekostal duhet të ketë gjithmonë një vetëdije dhe një reagim ndaj pranisë së Frymës së Shenjtë. Këto takime duhet të jenë plot me pjesëmarrës dhe të karakterizuara nga ndjeshmëria për personat e huaj (ata që vijnë nga jashtë kishës), të ketë rregullsi të përshtatshme dhe një etiketë që e nderon Krishtin (1 Korintasve 14).

Muzika dhe këngët kanë qenë një shprehje e adhurimit të Perëndisë që nga koha e Dhjatës së Vjetër. Anëtarët e kishës së hershme flisnin ndërmjet njëritjetrit me "psalme, himne dhe këngë frymërore", pra, duke kënduar dhe duke bërë muzikë për Zotin në zemrat e tyre (Efesianëve 5:19; Kolosianëve 3:16). Edhe ne duhet të ndjekim shembullin e tyre.

Megjithëse muzika dhe të kënduarit është përdorur në adhurim në mënyrë të përshtatshme, ato nuk duhet kurrë që të konsiderohen si sinonim i adhurimit. Adhurimi përfshin një shumëllojshmëri të gjerë gjërash, siç janë fjalët që i themi Perëndisë në lutje dhe lavdërim, mendimet tona të fiksuara tek e vërteta dhe karakteri i Tij, jetët tona të dhëna Atij në përkushtim me adhurim, trupat tanë që jetojnë në pastërti të perëndishme dhe në shërbim, ditët dhe orët tona që nderojnë vullnetin e Tij, dhuntitë tona që ia ofrojmë Perëndisë në lavdërim dhe falënderim. Mos e zvogëloshim kurrë gjerësinë dhe madhështinë e adhurimit duke e barazuar atë thjesht me një aspekt të vetëm të adhurimit.

Lutja është një aspekt vendimtar i shërbesës së kishës vendore. Cilësia dhe sasia e lutjeve të saj do të jenë masa e gjallërisë së saj frymërore.

Kisha e hershme karakterizohej nga lutja e saj. Ata luteshin për gjithçka: për përzgjedhjen e udhëheqës-

ve (Veprat e Apostujve 1:24; 6:6; 13:3), gjatë përndjekjes (Veprat 4:24-30; 12:5, 12), dhe përpara se t'u shërbenin të sëmurëve (Veprat 9:40; 28:8). Ata luteshin vazhdimisht. Luteshin në mënyrë vetjake dhe bashkërisht. Udhëheqësit e tyre ia dorëzonin veten lutjes (Veprat e Apostujve 6:1-4). Pali besonte se Fryma e Shenjtë do të siguronte ndihmë të mbinatyrshme kur të krishterët nuk do të dinin se si të luteshin (Romakëve 8:26, 27). Në rast se kisha e sotme dëshiron që të ndikojë kulturën e saj ashtu siç bëri kisha e parë, atëherë ajo duhet të jetë një kishë që lutet.


Administrimi është një formë e adhurimit. Megjithatë, është gjithashtu edhe një përgjegjësi. Ai fillon me njohurinë dhe pranimin që gjithçka i përket Perëndisë (Psalmi 24:1). Administrimi e sheh dhënien e të dhjetës (kthimin e 10 përqindëshit tek kisha vendore) si një reagim të përshtatshëm dhe plot adhurim ndaj Perëndisë (Malakia 3:8-10; Fjalët e Urta 3:9-10). Gjithashtu administrimi shtrihet përtej dhënies së të dhjetës, deri në zemërgjerësi që shprehet në ofrime të dhëna për të përmbushur nevojat të veçanta (1 Korintasve 16:1, 2; 2 Korintasve 8:1-15; 9:6-15; Fil. 4:10-20). Megjithatë, administrimi dështon në qoftë se në fund të fundit nuk e nderon Perëndinë në gjithçka (Kolosianëve 3:17; 1 Korintasve 10:31).

Asnjë prej qëllimeve biblike nuk negociohet; të gjitha janë thelbësore. Kur të gjitha këto gjejnë pasqyrim në një kishë vendore, atëherë e bëjnë atë kishë të shëndetshme dhe efikase. Ajo kishë që thekson vetëm një ose dy nga qëllimet, e kufizon shërbesën e saj dhe kthehet në një kishë jofunksionale. Në po të njëjtën mënyrë, i krishteri efikas dhe i pjekur është ai tek i cili gjen pasqyrim të përshtatshëm dhe të ekuilibruar secili prej qëllimeve. Në anën tjetër, një besimtar jofunksional është ai që është diplomuar në disa qëllime të preferuara dhe i ka lënë pas dore të tjerat. Ajo që kisha vendore është në makrokozmos, besimtarët individualë bëhen në mikrokozmos. Kemi nevojë për kisha të shëndetshme me qëllim që të prodhojmë dishepuj të shëndetshëm dhe efikasë.

LEROY R. BARTEL, D.Div., është dekan i Kolegjit të Biblës dhe Shërbesave të Kishës në Universitetin Jugperëndimor të Asambleve të Perëndisë në qytetin Uaksahaçi, Teksas.



DUKE USHTRUAR
ADMINISTRIM TË MIRË MBI
MARTESËN DHE FAMILJEN TUAJ



Nga: WAYDE & ROSALYN GOODALL

Bill Hybels, pastor i një prej kishave më të mëdha

në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ka shkruar: "Unë dhe Lini (bashkëshortja ime) nuk e kemi fshehur kurrë faktin se martesë jonë kërkon një punë të jashtëzakonshme, edhe më shumë se shumica e martesave të tjera. Ne kemi pothuajse dy dekada e gjysmë të martuar, dhe prapëseprapë duket se përparojmë me vështirësi në çdo hap të vogël që hedhim në rrugën drejt gëzimit martesor. Plagosja personale, ndryshimet mes karaktereve dhe presionet e një stili jashtëzakonisht të dukshëm (publik) jetese janë ato gjëra që përbëjnë sfidat tona. Por ne lutemi me njëri-tjetrin, flasim, kërkojmë këshillim, disiplinojmë vetveten, rritemi, ndryshojmë, premtojmë, kërkojmë falje, rrëfejmë, i përshtatim pritshmëritë tona, i kujtojmë vetes përkushtimet tona, shohim drejt të ardhmes dhe nuk pranojmë të heqim dorë. Gjendemi në këtë lidhje martesore për të gjithë jetën; kemi zgjedhur të qëndrojmë me partnerin "e rinisë sonë", dhe falënderojmë Perëndinë për secilin hap që na çon më pranë drejt gëzimit".¹



e shpresën e Zotit, ne gjithashtu e kuptojmë se një nga armët më të fuqishme që kemi për të luftuar këtë sulm mbi familjen është Fjala e paepur e Perëndisë. Megjithatë, shumica e kishave nuk zotërojnë programe gjithë përfshirëse të cilat të adresojnë nevojat e familjeve të lënduara apo që të përmirësojnë shëndetin e familjeve të forta.

E vlerësoj shumë transparencën e Billit. Në fakt duhet vërtet punë për të ndërtuar dhe mirëmbajtur një martesë të shëndetshme. Për fat të keq, disa shërbestarë dhe bashkëshortë nuk kanë martesë të shëndetshme, dhe as nuk kërkojnë ndihmë. Pastorët dhe bashkëshortet e tyre nuk iu hapen kolegëve të tyre të shërbesës në lidhje me sfidat martesore dhe nuk kërkojnë ndihmë prej tyre. Ata kanë frikë se miqtë e tyre do të flasin me të tjerët, ose që udhëheqësit e tyre të rajonit do ta zbulojnë këtë gjë dhe karriera e tyre do të jetë në rrezik.² Shërbestarët dhe bashkëshortet e tyre jetojnë fshehtas në dhimbje për shkak se gabimisht besojnë se shërbestarët dhe martesat e tyre duhet të jenë të përsosura.

MARRËDHËNIA MIDIS MARTESËS SË SHËNDETSHME TË SHËRBESTARIT DHE NJË KISHE TË SHËNDETSHME

Shumica e shërbestarëve e kuptojnë se institucioni i familjes në Amerikë është në telash. I kemi lexuar statistikën dhe i kemi parë edhe raportimet. Me shpresën e Zotit, ne gjithashtu e kuptojmë se një nga

armët më të fuqishme që kemi për ta luftuar këtë sulm mbi familjen është Fjala e paepur e Perëndisë. Megjithatë, shumica e kishave nuk zotërojnë programe gjithëpërfshirëse të cilat të adresojnë nevojat e familjeve të lënduara apo që të përmirësojnë shëndetin e familjeve të forta.

Shoqata Kombëtare e Ungjillorëve ka zbuluar një statistikë interesante. Ata kanë vërejtur se “vetëm disa pastorë kanë treguar se kishin marrë hapa domethënëse për të ndihmuar ata njerëz, familjet e të cilëve kishin telashe, megjithëse ata gjithashtu kanë pohuar se shpërbërja e familjeve është një problem relativisht i përhapur në bashkësitë e tyre”.³ Pse?

Në librin e tij me titull “Shërbesa e Familjes” (*FamilyMinistry*), Geri Sell (Gary Sell) jep një arsye të mundshme të këtij qëndrimi. “Padyshim që përgjigja është komplekse, por një nga raportet ka speculuar duke thënë se edhe vetë shumë familje të pastorëve kanë kaq shumë telashe sa që pastorët e shmangin fare temën e familjes. Në qoftë se kjo është e

S I TË RRITENI NË MARTESËN DHE SHËRBESEN TUAJ

“Dhe të përtëriheni në frymën e mendjes suaj” (Efesianëve 4:23).

TRI FUSHA KU TË FOKUSOHENI:

1. RRITUNI MË SHUMË NË JETËN TUAJ PERSONALE.

“Dhe Jezusi rritej në urtësi, dhe në shtat dhe në hir përpara Perëndisë dhe njerëzve” (Luka 2:52).

“Shmangu pra nga përrallat profane dhe të të vjetërve, edhe ushtrohu në perëndishmëri” (1 Timoteut 4:7).

“Kini të njëjtat mendime njëri me tjetrin; mos e kini mendjen për lart, por qëndroni me të përlulur” (Romakëve 12:6).

2. RRITUNI MË SHUMË NË MBËSHTETJEN QË I JEPNI BASHKËSHORTES SUAJ.

“Dy vlejné më mirë se një i vetëm, sepse kanë një shpërblim të mirë për mundin e tyre. Në fakt nëse rrëzohen, njëri ngre tjetrin” (Predikuesit 4:9,10).

“Ju gratë, jini të nënshtruara burrave tuaj, ashtu si ka hije në Zotin” (Kolozianëve 3:18).

“Ju burrat, duajini gratë tuaja dhe mos u bëni të hidhur ndaj tyre” (Kolozianëve 3:19).

“Dhe le të kujdesemi për njëri-tjetrin, për t’u nxitur për dashuri dhe vepra të mira” (Hebrenjve 10:24).

“Prandaj ngushëlloni njëri-tjetrin dhe ndërtoni njëri-tjetrin ashtu sikur edhe bëni” (1 Thesalonikasve 5:11).

3. RRITUNI MË SHUMË NË DORËZIMIN TUAJ NDAJ PERËNDISË.

“Sepse, nëse këto gjëra gjenden në ju dhe shtohen, nuk do t’ju lejojnë të bëheni përtacë dhe as të pafryt në njohjen e Zotit tonë Jezu Krisht” (2 e Pjetrit 1:8).

“U kryqëzova bashkë me Krishtin; por rroj; jo më unë, po Krishti rron në mua; por ajo që tani jetoj në mish, e jetoj në besimin e Birit të Perëndisë, që më deshi dhe dha veten për mua” (Galatasve 2:20).

Wayde I. Goodall,
Uinston-Salem, Karolina e Veriut

vërtetë, pra, nëse pastorët kanë frikë t'iu përvishen çështjeve të familjes që të mos tërheqin vëmendjen drejt jetës së tyre të sëmurë familjare, atëherë kjo mund të na tregojë më shumë rreth bashkësive sesa rreth pastorëve. Ndoshta pastorët janë të kërcënuar nga qëndrimi i shumë-përhapur se dështimi në jetën familjare është më pak i tolerueshëm sesa dështimet e tjera. Ne i lejojmë udhëheqësit tanë që të predikojnë dhe të na japim mësim rreth lutjes, ungjillëzimit dhe çështjeve të tjera "frymërore" pa prituri që ata vetë t'i kenë zotëruar ato plotësisht. E megjithatë, mund të mos i lejojmë që të kenë vështirësi si bashkëshortë apo si prindër".⁴

Vetëm në rast se pastori ka një martesë të shëndetshme, ndoshta do të sigurojë mësimet dhe burimet e nevojshme për njerëzit e tij që të zhvillojnë martesë të shëndetshme. Në qoftë se ajo që thotë Sell është e vërtetë, atëherë pastorët duhet të forcojnë martesat e tyre si një model dhe si një inkurajim për ata persona në bashkësitë e tyre të cilët kanë nevojë të forcojnë martesat e tyre.

Atëherë çfarë të bëjmë? Duke qenë se shërbetarët kanë të njëjtat vështirësi në jetë siç kanë edhe njerëzit të cilëve iu shërbejnë, na duhet të gjejmë mënyra për të komunikuar, për të disiplinuar fëmijët tanë, për t'u përballur me konfliktin, stresin, sëmundjen, tragjedinë, dhimbjen dhe zhgënjimin. Gjithashtu duhet të punojmë me synimin drejt ndërtimit të një martese të shëndetshme.

DUKE MBROJTUR MARTESAT NË SHËRBESË

Martekat e shërbetarëve kanë shumë prej të njëjtave problematika si martesat e tjera, por ato gjithashtu kanë edhe beteja unike që i shtohen sfidës për të zhvilluar një martesë të shëndetshme. Pas 25 vitesh në shërbesë si pastorë dhe pasi kemi dëgjuar me qindra shërbetarë dhe bashkëshortet e tyre teksa shprehin shqetësime martesore, kemi zbuluar që shumica e dhimbjes (lëndimit) në martesat e shërbetarëve vjen nga tetë çështje. Është shumë e nevojshme, për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e martesave të shëndetshme, që të identifikojmë çështjet që sfidojnë martesat në shërbesë dhe të zhvillojmë një strategji për t'i luftuar ato. Më poshtë janë tetë nga fushat që do t'i ndihmojnë pastorët të ndërtojnë një martesë dhe një familje të shëndetshme në shtëpitë e besimtarëve të tyre.

1. **Bëni familjen, dhe jo kishën, fokusin parësor në jetën tuaj.** Menjëherë pas marrëdhënies tuaj me Krishtin, marrëdhënia e radhës më e rëndësishme për një shërbetar është ajo me bashkëshorten e tij dhe me fëmijët. Shumica e shërbetarëve punojnë fort në atë që bëjnë. Njësoj si menaxherët kryesorë nëpër kompani, edhe ata punojnë mesatarisht 55 orë ose më shumë në javë. Është sfilitëse që të jeni në

gatishmëri 24 orë në ditë, 7 ditë të javës dhe gjithë vitin ndërkohë që përpiqeni të jeni të përgatitur për të përmbushur nevojat e njerëzve. Jezusi nuk ju ka kërkuar të merreni me shërbesën pa i kushtuar vëmendje familjes suaj apo nevojave vetjake që keni për të pushuar, për t'u rifreskuar dhe për t'u ripërtërirë. Konteksti i Shkrimit ju nxit të fokusoheni tek gjetja e ekuilibrit. Jezusi tha: "Sepse zgjedha ime është e butë dhe barra ime është e lehtë!" (Mateu 11:30).

2. **Mësoni të përballeni me pritshmëri që nuk janë reale.** Disa vetë në bashkësinë tuaj mendojnë se ju punoni për ta. Shumë shërbetarë janë të shqetësuar se mos humbasin punën, dhe kështu lejojnë pritshmëritë nga besimtarët e tyre, të cilat nuk janë reale, të pushtojnë jetët e tyre personale. Gjetja e drejtpeshimit (ekuilibrit) mes asaj që mund të bëni dhe asaj që nuk mund të bëni, të mësoni si të delegoni dhe kujt t'ia delegoni, janë gjëra shumë vendimtare për një jetë të shëndetshme. Kishte raste kur Jezusi u largua nga përgjegjësitë e shërbesës për të marrë rifreskim personal. Këtë aftësi duhet ta zhvillonin edhe ju gjithashtu. Megjithatë "turma të mëdha mbledheshin për ta

SI TË RUHENI QË SHËRBESA TË MOS E VRASË MARTESËN TUAJ

MBANI NJË PERCEPTIM REALIST. UNË JAM:

- një person i zakonshëm (Gjoni 6:1-13).
- një person i aftë (Filipianëve 4:13).
- një person i sigurt në vetvete (Jeremia 17:5-8).

I BËNI VETES PYETJET E DUHURA:

- A e di unë se kur duhet thënë po?
- A e di unë se kur duhet thënë jo?
- Zërin e kujt po dëgjoj, të Perëndisë apo të njeriut?
- A mund ta pranoj kritikën, si atë profesionale, edhe atë personale?

RIKONTROLLONI QËLLIMIN E JETËS SUAJ:

- Kë po përpiqem të kënaq?
"Prandaj edhe e kemi për nder t'i pëlqejmë atij" (2 Korintasve 5:9).

PRISNI PËRVOJA TË VËSHTIRA NË SHËRBESË:

- Mbani një perspektivë të mbretërisë.
"Ju keni kurdisur të këqija kundër meje, por Perëndia ka dashur që t'i shërbejë së mirës, për të kryer atë që po ndodh sot: të mbash gjallë një popull të shumtë" (Zanafilla 50:20).

Wayde I. Goodall,
Uinston-Salem, Karolina e Veriut

dëgjuar dhe për t'u shëruar prej tij nga sëmundjet e veta... ai [Jezusi] tërhiqej në vende të vetmuara dhe lutej” (Luka 5:15, 16).

3. **Parashikoni që do të merrni kritika.** Kur udhëhiqni, do të merrni kritika. Jezusin e kritikuan; po kështu edhe dishepujt. Të gjithë udhëheqësit kritikohen. Ndonjëherë kritikën jepen në një mënyrë të vrazhdë, të ashpër dhe të pajustificueshme. Duhet të mësoni të mos i merrni personalisht këto kritika dhe gjithashtu të largoheni prej tyre pa i lejuar që të ndikojnë në humorin tuaj. Disa kritikë kanë nevojë të kthjellohen sadopak, dhe disa nga ata që kritikohen kanë nevojë të burrërohen paksa. Ndonjëherë kritikën përmbajnë gjëra të vërteta. Gjithsecili prej nesh ka nevojë për përmirësim, dhe na bën mirë t'u vëmë veshin kritikëve tanë. Në vend që t'i lejoni kritikën t'ju çojnë në depresion, kuptoni se kritikën mund t'ju ofrojnë mundësi që të rriteni.

4. **Mbajeni kalendarin tuaj nën kontroll.** Në qoftë se ju nuk e kontrolloni vetë kohën tuaj, atëherë do ta kontrollojë dikush tjetër. Takimet e mbrëmjeve vonë mund të vazhdojnë rresht çdo natë. Shënoni kohë të veçuar në kalendarin tuaj për netët me familjen dhe për netët për të dalë me bashkëshortin tuaj. U thoni personave që dëshirojnë të lënë një takim se gjatë atyre netëve keni një takim të rëndësishëm. Është e vërtetë; sepse, kush mund të jetë më e rëndësishme sesa familja juaj?

5. **Mësoni si të menaxhoni stresin.** Eventualisht stresi do të ndikojë në martesën tuaj. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, rreth 30 milion burra e përshkruajnë veten si të stresuar.⁵ Në shërbesë, shpesh kaloni kohë të cilat kanë stres të jashtëzakonshëm. Mësimi i teknikave menaxhuese të stresit është vendimtar nëse do të doni të gjeni një jetë të ekuilibruar që përfshin një martesë të shëndetshme dhe një karrierë besnike në shërbesë. Shërbëtarët e kalitur shpesh kanë gjetur mënyra të mira për ta menaxhuar siç duhet e për ta përballuar me sukses stresin. Një psikolog i krishterë që punon me shërbëtarë të rraskapitur nga shërbesa, jep këto pesë ide për të shmangur rraskapitjen:

- Mësoni që nuk mund t'i bëni të gjitha.
- I caktoni një ritëm vetes.
- Delegoni.
- Merrni kohë për të pushuar.
- Dëgjoni trupin tuaj.

Njerëzit që kujdesen për të tjerët, janë zakonisht ata që pësojnë rraskapitje. Si shërbëtarë, tashmë jeni në biznesin e dhënies së kujdesjes.

6. **Mësoni të përballeni me kufizime ekonomike.** Afërsisht 64 përqind e pastorëve të Asambleve të Perëndisë shërbejnë në kisha me nga 99 njerëz ose më pak. Shumë prej tyre kanë kufizime ekonomike dhe jetojnë me buxhete të shtrënguara. Disa mund të kenë nevojë për këshilla nga një planifikues financiar i krishterë për të përshtatur shpenzimet e tyre ose për të zhvilluar një buxhet. Disa të tjerë madje mund të kenë nevojë të gjejnë një mënyrë për të plotësuar nevojat e familjeve të tyre përmes zanateve, pra, që të punojnë në një punë të dytë që nuk ka lidhje me shërbesën.

7. **Mbajeni veten të dëlirë (të pastër) seksualisht dhe shmanguni nga situatat komprometuese.** Nuk është e pazakontë që njerëzit në bashkësinë tuaj të admirojnë, dhe në disa raste më shumë se sa thjesht të admirojnë, çiftin pastoral. Jini të vëmendshëm ndaj kësaj dhe dëgjoni bashkëshortin/in tuaj, sepse ai/ajo mund të jetë/i/e ndjeshme ndaj dikujt të gjinisë tjetër, i cili ka ndjenja të papërshtatshme. Gjithashtu shërbëtarët, kur këshillojnë një grua në bashkësi, duhet të mbështeten tek opinioni i bashkëshorteve të tyre. Në më të shumtën e rasteve, këshillimi i personave të gjinisë tjetër duhet të bëhet si çift.

8. **Mësoni të përballeni me shkurajimin.** Një misionar i urtë më ka thënë se një nga armët më të fuqishme që armiku përdor kundër shërbëtarëve është pikërisht shkurajimi. Bashkë me zënieën me punë vijnë edhe kohët e shkurajimit. Në qoftë se nuk jeni të kujdesshëm, shkurajimi mund të jetë një problem gjymtues në shërbesën dhe në martesën tuaj. Duhet të zhvilloni një mendësi duke pasur parasysh tablonë e madhe, pra, të kuptoni se Perëndia është duke punuar, madje edhe kur kohët e shtrëngimit e bëjnë të vështirë ta shohim Atë. Pjetri shkroi: “Dhe Perëndia i çdo hiri, që na thirri në lavdinë e tij të përjetshme në Krishtin Jezus, mbasi të keni vuajtur për pak kohë, ai vetë ju bëftë të përsosur, ju mbështetë, ju forcoftë dhe ju themeloftë” (1 e Pjetrit 5:10).

PRINDËRIMI DHE BASHKËSIA E BESIMTARËVE

Ashtu siç ka çështje unike me të cilat përballen çiftet në shërbesë për t'i mbajtur martesat e tyre të shëndetshme, po ashtu zhvillimi dhe mirëmbajtja e marrëdhënieve të shëndetshme me fëmijët tanë i paraqet prindërit me një set tërësisht të ri problemesh. Prindërit duhet të fokusohen në pesë sfera kryesore të rritjes së fëmijës: dashuria, shembulli, disiplina, qëndrueshmëria dhe në përfshirjen e babait në familje.

Dashuria: Nënata dhe baballarët duhet ta duan njëri-tjetrin dhe t'i duan fëmijët e tyre. Dashuria jonë për njëri-tjetrin duhet të jetë e dukshme tek fëmijët tanë. Dashuria jonë për secilin fëmijë duhet të shfaqë ato karakteristika që gjenden tek 1 Korintasve 13:4-7.

Shpeshherë u kemi thënë njerëzve në bashkësinë tonë që fëmijët tanë janë njësoj si fëmijët e tyre. Fakti që fëmijët tanë janë të lidhur me pastorin nuk ua heq atyre gjendjen e tyre normale dhe nevojën që ata kanë për t'u rritur si njerëz. Gjithashtu nuk i izolon ata nga çështjet normale me të cilat përballlet çdo i ri/e në jetën e vet.

Shembulli: Ne jemi një shembull për fëmijët tanë me mënyrën si veprojmë, reagojmë, me gjërat që themi, qëndrimet që mbajmë dhe me emocionet që tregojmë. Mënyra se si e modelojmë ne jetën e krishterë përpara fëmijëve tanë do të ketë një ndikim të madh në mënyrën se si zgjedhin ata që t'i jetojnë jetët e tyre. Fëmijët mësojnë nga ato që ne bëjmë, jo nga ato që themi.

Disiplina: Gjithsecili ka nevojë për kufij, kufizime dhe direktiva. Disiplina siguron gardhet në jetë. Disiplina përfshin dhënien e udhëzimeve edhe për sjelljen e

duhur, jo thjesht për sjelljen e gabuar. Disiplina duhet të jetë e drejtë, në kohën e duhur, e qëndrueshme dhe të dy prindërit duhet të jenë në dakordësi. Çdo fëmijë ka një personalitet të ndryshëm. Ndoshta do të na duhet të përdorim lloje të ndryshme disiplinash për secilin fëmijë.

Qëndrueshmëria: Jo vetëm që është e domosdoshme të jemi të qëndrueshëm me disiplinimin tonë, por duhet të jemi të qëndrueshëm me dashurinë tonë për njëri-tjetrin (si burrë dhe grua) dhe për fëmijët tanë. Në qoftë se jemi të qëndrueshëm, jemi edhe të parashikueshëm. Fëmijët tanë do ta dinë se si do të veprojmë apo reagojmë ndaj disa llojeve të caktuara të sjelljes (qoftë të mira apo të këqija). Sjellja e paarsyeshme, emocionalisht jashtë kontrollit dhe befasuese nga ana e prindërve inkurajon mos-funksionimin jo vetëm në jetën e fëmijës, por gjithashtu edhe të familjes.

Babai: Në një studim që përfshinte 994 çifte me fëmijë, hulumtuesit zbuluan se fëmijët që kishin kaluar më shumë kohë me baballarët kishin më pak probleme në sjellje. Në një tjetër studim ku përfshiheshin 14.700 vajza adoleshente, hulumtuesit zbuluan se sa më e ngushtë të ishte marrëdhënia që një vajzë kishte me babanë e saj, aq më shumë gjasa kishte që ajo t'i shtynte marrëdhëniet seksuale dhe aq më pak gjasa kishte që ajo të përdorte substanca narkotike dhe alkool (Elias 1998).⁶

Shpeshherë pastori i ngarkuar është babai i munguar. Është vendimtare që babai (pastori, misionari apo ungjilltari) të jetë i përfshirë në jetën e fëmijës së tij/saj. Këtu përfshihet disiplina, drejtimi frymëror si dhe aktivitetet e tjera edukative, sportive dhe çlodhëse.

Dikush pyeti: "Si ia shqipton (shpjegon) dashurinë një fëmijë?".

Përgjigja: "Me kohën".

Martesa dhe familja juaj është një shembull ndaj njerëzve të cilëve iu shërbeni. Një nga gjërat më fantastike që mund të bëni si një shërbestar është që të demonstroi mënyrën se si funksionon një familje e shëndetshme dhe se si i respekton ajo të gjithë anëtarët. Ju nuk jeni të përsosur; martesa juaj nuk është e përsosur; fëmijët tuaj nuk janë të përsosur. Megjithatë, kur familja juaj merr prioritet më të madh sesa shërbesa juaj, atëherë po iu tregoni njerëzve, të cilëve iu shërbeni, rëndësinë që ka jeta familjare.

"Familja", sipas fjalëve të një shkencëtari social, "është ndikimi më i madh nga të gjithë mbi atë se kush jemi dhe çfarë bëjmë". Ai e vazhdoi edhe më tej shpjegimin: "Familjet ku jemi lindur dhe ato në të cilat jetojmë si të rritur, na japin formë që nga lindja deri

SI TË RUHENI QË SHËRBESA TË MOS E VRASË MARTESËN TUAJ

MBANI NJË PERCEPTIM REALIST. UNË JAM:

- një person i zakonshëm (Gjoni 6:1-13).
- një person i aftë (Filipianëve 4:13).
- një person i sigurt në vetvete (Jeremia 17:5-8).

I BËNI VETES PYETJET E DUHURA:

- A e di unë se kur duhet thënë po?
- A e di unë se kur duhet thënë jo?
- Zërin e kujt po dëgjoj, të Perëndisë apo të njeriut?
- A mund ta pranoj kritikën, si atë profesionale, edhe atë personale?

RIKONTROLLONI QËLLIMIN E JETËS SUAJ:

- Kë po përpiqem të kënaq?
"Prandaj edhe e kemi për nder t'i pëlqejmë atij" (2 Korintasve 5:9).

PRISNI PËRVOJA TË VËSHTIRA NË SHËRBESË:

- Mbani një perspektivë të mbretërisë.
"Ju keni kurdisur të këqija kundër meje, por Perëndia ka dashur që t'i shërbejë së mirës, për të kryer atë që po ndodh sot: të mbash gjallë një popull të shumtë" (Zanafilla 50:20).

**Wayde I. Goodall,
Uinston-Salem, Karolina e Veriut**

S I TA BËNI MARTESËN DHE FAMILJEN TUAJ QË TË FUNKSIONOJË

Megjithëse divorci në mesin e klerikëve është më i ulët sesa në martesat e profesioneve të tjera, shkalla e divorceve të klerit është duke u rritur. Cili është shkaku për këtë?

Shkaku më i shpeshtë është tradhtia bashkëshortore. Shërbestari përfshihet në një marrëdhënie me dikë tjetër. Kur bashkëshortja e shërbestarit e lë atë për të qëndruar me një burrë tjetër, ankesa më e zakonshme që jepet, është preokupimi i shërbestarit me punën e tij. Në secilin rast, shkaku themelor është që nuk kalojnë mjaftueshëm kohë së bashku, pra, shpenzojnë shumë kohë veç e veç.

Kur një shërbestar shpenzon 12 deri në 14 orë në ditë në punë, atëherë nuk ngelet kohë dhe energji e mjaftueshme për të investuar në martesë dhe tek fëmijët. Koha kur energjia është në nivelet më të larta shpenzohet larg njëri-tjetrit. Çifti që e privon njëri-tjetrin nga kjo kohë plot energji, është duke mashtruar njëri-tjetrin . . . duke vjedhur nga njëri-tjetri kohën

dhe energjinë e nevojshme për të krijuar një martesë të shëndetshme. Pali paralajmëroi se kjo i çon të dy partnerët drejt tundimit (1 Korintasve 7:5). Pastaj, është thjesht çështje kohe se kë do të fusë armiku të parin në kurth.

Disa shërbestarë e kanë të vështirë ta kenë martesën dhe familjen e tyre një prioritet përpara interesave të institucionit të kishës. Ndonjëherë këshilla e Palit është e dobishme për t'u mbajtur mend që pastori duhet të modelojë jetën e krishterë dhe të tjerët duhet ta ndjekin (1 Timoteut 3:1-5). Duke qenë një bashkëshort i dashur dhe i ndjeshëm, shërbestari u tregon çiftve të tjera se si duhet ta trajtojnë njëri-tjetrin.

Pastorët që e organizojnë mirë punën e tyre, hasin në shumë pak raste kur puna e tyre bie në konflikt me jetën e tyre familjare. Pastori i urtë ia kursen familjes së tij bashkëbisedimet e pakëndshme rreth problemeve të kishës. Në qoftë se besimtarët e ndërpresin kohën tuaj

familjare me telefonata të padëmshme, inkurajojini ata me butësi që t'i bëjnë telefonatat e tyre të zakonshme gjatë orarit zyrtar të punës. Njoftojini se kur vjen puna për telefonata urgjente, ju do të jeni gjithmonë të disponueshëm që t'ju marrin edhe në shtëpi.

Ndoshta mund të thoni diçka të tillë: "Jam shumë i gëzuar që si pastor jam i rrethuar me njerëz të vëmendshëm siç jeni ju. Dëshira ime, siç e dini, është të jem me ju kurdoherë që keni urgjenca në familjen tuaj. Si pastori juaj, unë dua të kujdesem për ju. Megjithatë, respekti dhe dashuria juaj për mua dhe familjen time tregohet më së miri, dhe në mënyrë më praktike, me faktin që nuk do e ndërprisni kohën tonë familjare për probleme që mund të presin dhe të zgjidhen në zyrën time gjatë ditës".

Richard D. Dobbins, Ph.D.,
psikolog klinike dhe themelues dhe
drejtor i EMERGE, Akron, Ohajo

në vdekje. Ato janë shkaku i drejtpërdrejtë i kohëve tona më të mira dhe atyre më të këqija. Asnjë lidhje tjetër nuk na afron me njëri-tjetrin ashtu siç na lidh familja, dhe asnjë gjë nuk ka më shumë ndikim".⁷ Në qoftë se kjo është e vërtetë, martesat dhe familja juaj ka një ndikim të jashtëzakonshëm, jo vetëm tek ju, por tek ata të cilëve iu shërbeni.

Njerëzit në kishën tuaj janë duke kërkuar në mënyrë të dëshpëruar për një shembull të mirë në martesat dhe familjen e tyre. Në qoftë se qëndroni të shëndetshëm (ose punoni për të qenë të shëndetshëm) në këtë fushë të jetës suaj, atëherë kjo do të japë përfitime të mëdha për të gjithë ata që janë të përfshirë.

SHËNIME

1. Bill Hybels, *Making Life Work* (Downers Grove: InterVarsity Press, 1998), 136.
2. Edhe në vështirësi ekstreme martesore, rajonet tona janë të disponueshme për të ndihmuar shërbestarin. Unë kam qenë dëshmitar i një

sërë rastesh kur zyrtarë të rajonit kanë demonstruar zemërgjerësi dhe mirëkuptim të jashtëzakonshëm.

3. Ted Ward, "Report of the Task Force on the Family of the National Association of Evangelicals" (1988), 1.
4. Charles M. Sell, *Family Ministry* (Grand Rapids: Zondervan Publishing House, 1995), 14.
5. Richard Swenson, M.D., *Margin: Creating the Emotional, Physical, Financial, and Time Reserves You Need* (Colorado Springs: Navpress, 1992). Dr. Swenson është drejtori i Qendrës Studimore për Shëndetin në të Ardhmen në Menomoni, Uiskonsin.
6. Stephen A. Grunlan, *Marriage and the Family: A Christian Perspective* (Grand Rapids: Zondervan Publishing House 1999), 242.
7. Steven L. Nock, *Sociology of the Family* (Englewood Cliffs, N.J.: Prentice-Hall, 1987), xi.



WAYDE GOODALL, D. Min, është pastori kryesor i Asamblesë së Parë të Perëndisë në Uinston-Salem të Karolinës së Veriut.

ROSALYN GOODALL, ka shërbyer bashkë me bashkëshortin e saj në shërbesë për më shumë se 25 vjet.



**VETËPËRMBAJTJA
NGA ANKESAT:
UDHËHEQËSIT OPTIMISTË IU
SHKOJNË GJËRAVE DERI NË FUND**

Nga: SCOTT HAGAN



rahjet e zemrës së Miriamit ishin duke u shtuar nxitimthi. Kështu do të shtoheshin edhe tuaajat apo të miat. Llogaridhënia ishte një gjë, por të kesh të bësh me vetë të Plotfuqishmin që të jep një mësim personalisht bashkë me një dozë lebre, ishte një goxha përvojë e një tjetër lloji. Në një çast, Miriami ishte duke abuzuar me pozitën e saj brenda familjes duke kritikuar Moisiun, vëllanë e saj më të vogël, por tashmë të rritur. Pastaj, sa hap e mbyll sytë, lëkura e saj ngjyrë ulliri ishte çngjyrosur nga lebra e ishte bërë e bardhë si bora. (Shihni Numrat 12).

Miriami besonte se ankesa e saj kundër Moisiut nuk ishte asgjë tjetër veçse një shqetësim i arsyeshëm. Në fund të fundit, bashkëshortja e Moisiut, që ishte etiopase, kishte zaptuar rrethin e saj të brendshëm. Duke u ndjerë sikur po humbiste pozitën e saj, Miriami e shihte bashkëshorten e Moisiut si një kriminele dhe jo si kunatë. Madje as dashuria që kishte për vëllanë nuk mundi ta ndalte gjuhën e saj. Goja e saj kërkonte të bënte atë që ushtritë e Faraonit nuk mundën të bënin, pra, të rrëzonin Moisiun. Me ndihmën e Aaronit, vëllait të saj më të vogël, që të dy, vëlla e motër, shpërthyen në kritika. Pastaj papritur, të dy vëllezërit e saj, si Moisiu edhe Aaroni, e vështuruan të tmerruar ndërkohë që Perëndia, po Ai i cili kishte shkatërruar Egjiptin, tani po ballafaqohej me motrën e tyre.

Por fryma negative që ishte shpërndarë nëpër Izrael si një kancer që përhapet me shpejtësi, nuk e kishte fillësën tek fjalimi shkatërrues i Miriamit. Në fakt, kjo ishte faza e dytë. Historia e vërtetë kishte filluar disa ditë më herët. Tek Numrat 11:1 na tregohet: “Por populli u ankua dhe kjo nuk tingëlloi mirë në veshët e Zotit; sa e dëgjo, Zoti u zemërua, dhe zjarri i tij shpërtheu midis tyre dhe shkatërroi skajin e kampit”. Moisiu u lut dhe zjarri u shua. Por problemi i ankimit nuk kishte mbaruar. Vargu 4 na thotë: “Dhe fundërrinën heterogjene që ishte midis popullit e pushtoi një lakmi e madhe; edhe bijtë e Izraelit filluan të ankohen dhe të thonë: „Kush do të na japë mish për të ngrënë?””

Vini re që fryma kritike në Izrael fillon në periferi ose në skajet e kampit. Pikërisht aty ra edhe zjarri si fillim. Bibla i quan nxitësit kryesorë “fundërrinën heterogjene”, që është një term interesant, sepse do të thotë “një mori e përzier njerëzish”. Këta ishin ata persona që i ishin bashkuar rrugës Izraelit për të dalë nga Egjipti, jo ngaqë e donin Perëndinë, por vetëm për shkak të pakënaqësisë dhe urrejtjes kundër Faraonit. Fundërrina heterogjene nuk ishte e përkushtuar ndaj Jehovës apo ndaj popullit të Tij; ata thjesht donin të çliroheshin nga Egjipti. Për shkak se ky ishte motivi i tyre i brendshëm, ata jetonin në skajet e kampit. Adhurimi ishte gjëja e fundit që iu

kalonte nëpër mend. Sa ironike që ankesa filloi pikërisht atje!

Gjithashtu këtu fillon zakonisht edhe negativiteti në jetën e një udhëheqësi ... në skajet e kota dhe në çikërrimat periferike të jetës dhe të udhëheqjes së tij. Pikërisht në skajin e zemrës së tij, udhëheqësi është më i cenueshëm. Armiku dëshiron ta prishë frytin që jep udhëheqësi dhe ta ndalojë vrullin e tij duke e tunduar nëpër modele të përsëritura negativiteti. Si udhëheqës, ne rrëshqasim në këtë model të përsëritur atëherë kur ankohemi rreth gjërave rastësore. Ne nuk e kuptojmë se ankesat e lëna në mënyrë të shfrenuar mund të përfundojnë fare mirë në një periudhë lebre udhëheqësie.

Satanit i pëlqen shumë t'i fusë në kurth udhëheqësit në skajet e tyre negative. Pasi të zënë vend mirë, këto skaje do të fillojnë të brejnë jetën e tyre të brendshme të mbretërisë. Shërbestarët mund të jenë ofenduesit më të këqij. Ndonjëherë veprimet tona nuk kanë asnjë ndryshim nga ato të fundërrinës

© 2008 Paul F. Gray



“Duhet të jemi shumë të mëshirshëm me pastorin e ri. Nuk është faji i tij që ju keni pasur pastorin më të dashur, më të zgjuar dhe më elokuent që ka jetuar ndonjëherë mbi dhe...”

Armiku dëshiron ta prishë frytin që jep udhëheqësi dhe ta ndalojë vrullin e tij duke e tunduar nëpër modele të përsëritura negativiteti.

heterogjene të Dhjatës së Vjetër. Ne kritikojmë predikimin apo kostumin e një pastori tjetër. Lëshojmë fyerje dhe sharje ndaj drejtuesve të shërbesave në kishë. E megjithatë, Perëndia kërkon llogari nga një udhëheqës për dobësitë e tij personale, aty ku ekzistojnë gjërat e parëndësishme të jetës. Mënyra më e zakonshme me të cilën një udhëheqës lejon që ndikimi që ai ka të përkeqësohet, është përmes shpërdorimit të energjive dhe të fjalëve të tij mbi çështjet e parëndësishme të jetës.

Tek veprimet e Miriamit gjejmë edhe stadin pasardhës, ku një udhëheqës saboton qëndrueshmërinë e tij (ose aftësinë për të mbështetur veten) në shërbesë. Mbi thembrat e skajeve të rëna të Izraelit, marrëdhëniet thelbësore brenda strukturës së udhëheqësisë së Izraelit ishin të prishura. Kjo qëndron e vërtetë edhe sot; ne thjesht e kemi paksa të vështirë ta pranojmë atë. Për një arsye ose një tjetër, shumë udhëheqës, ashtu si Miriami, ndjejnë një lloj lirie për të kritikuar ata që janë më pranë tyre në udhëheqje. Megjithatë, Fryma e Shenjtë kërkon llogaridhënie prej nesh, ashtu siç bëri me Miriamin, në rast se flasim kundër atyre që duam dhe kundër atyre me të cilët udhëheqim përgjatë rrugës.

Perëndia do që skajet tona të jenë të pastra, por Ai gjithashtu kërkon që ne të kemi sukses me marrëdhëniet thelbësore në jetët tona. Perëndia e goditi Miriamin me lebër, sepse ajo e lejoi veten që të sillej negativisht në marrëdhëniet familjare. Udhëheqësit, për arsye të ndryshme, kanë tendencë që të ndjekin të njëjtin model. Ne ankohemi rreth gjërave që nuk kanë rëndësi, pastaj po aq kollaj ankohemi edhe për gjërat më të çmuara. Ekziston një rregull i pathënë në udhëheqje që duket se i jep besueshmëri këtij lloji modeli. Një vështrim i shpejtë tek Numrat 14 na tregon se papritur i gjithë kombi i Izraelit filloi të ankohet. Kjo është pasoja e natyrshme kur skaji ynë dhe bërthama jonë korruptohen (prishen) me ndjenja

dhe fjalë negative. Gjithçka tjetër shkon për keq. Ky është një realitet i fuqishëm i udhëheqjes: Tërësia e kësaj është rezultat i skajit negativ dhe i bërthamës së pashëndetshme.

Duket se udhëheqësit optimistë udhëheqin për të gjithë jetën. Udhëheqësit që ankohen, pavarësisht se sa e parëndësishme mund të duket ankesa në sytë e tyre, zakonisht çngjyrosen me kalimin e kohës. Njerëzit nuk kanë ç'e duan negativitetin, sidomos tek udhëheqësit e tyre. Ata dëshirojnë të frymëzohen për lart.

Shërbesa është pak a shumë si mana; në disa raste duket si pa shije dhe e përsëritur. Ka mjaft hapësirë për të shkuar drejt atij skaji negativ. Gjithashtu ekziston një presion i jashtëzakonshëm në marrëdhëniet tona ekzekutive, pra, me ata me të cilët shkojmë krah për krah në betejë. Është goxha e lehtë të jemi të lëshuar dhe të shkujdesur dhe të pësojmë ofendim nga ata të cilët i kemi më për zemër.

Udhëheqësit e qëndrueshëm i mbajnë zemrat e tyre të pastra në të dy spektrat, edhe tek skaji, edhe tek bërthama. Ata e kuptojnë se janë shumë gjëra në rrezik... që tërësia ose do të qëndrojë e shëndetshme ose do të pushtohet nga ankimi që shtyn kundër tyre nga skajet dhe nga bërthama. Është koha që të keni vetëpërmbytje të përkorë nga ankesat.



SCOTT HAGAN është pastori kryesor në kishën "Jeta Reale" të Asambleve të Perëndisë në qytetin Sacramento të Kalifornisë.

10 KARAKTERISTIKA KISHE TË



Një

kishë e shëndetshme është e devotshme në të gjitha aspektet e mëposhtme të jetës dhe shërbesës së kishës; mbështetet tek fuqia e Perëndisë dhe tek autoriteti i Fjalës së Tij, si dhe vlerëson:

1. **Praninë fuqizuese të Perëndisë.** Kisha e shëndetshme kërkon në mënyrë aktive drejtimin dhe fuqizimin e Frymës së Shenjtë për jetën dhe shërbesën e saj të përditshme.
2. **Adhurimin që lartëson Perëndinë.** Kisha e shëndetshme mblidhet rregullisht si një shprehje vendore e trupit të Krishtit për të adhuruar Perëndinë në mënyra që angazhojnë zemrat, mendjet, shpirtrat dhe forcat e njerëzve.
3. **Disiplinat frymërore.** Kisha e shëndetshme ofron trajnim, modele dhe burime për anëtarët e të gjitha moshave, me qëllim që të zhvillojë disiplinat e tyre frymërore të përditshme.
4. **Mësimin dhe rritjen në komunitet.** Kisha e shëndetshme i inkurajon besimtarët që të rriten në rrugëtimin e tyre me Perëndinë, por edhe me njëri-tjetrin, brenda kontekstit të një atmosfere të sigurt dhe konfirmuese.
5. **Një përkushtim ndaj marrëdhënieve dashamirëse.** Kisha e shëndetshme është e qëllimshme në përpjekjet e saj për të ndërtuar marrëdhënie dashamirëse e të përzemërta brenda familjeve, midis anëtarëve, si dhe brenda komunitetit.
6. **Zhvillimin e udhëheqjes prej shërbëtori.** Kisha e shëndetshme identifikon dhe zhvillon ata individë të cilët Perëndia i ka thirrur dhe iu ka dhënë dhuntinë e udhëheqjes, dhe i sfidon ata për të qenë udhëheqës - shërbëtorë.



TË NJË SHËNDETSHME

Nga: **STEPHEN A. MACCHIA**



7. **Një fokus të jashtëm.** Kisha e shëndetshme i jep prioritet të lartë komunikimit ose përcjelljes së të vërtetës së Jezusit, si dhe demonstrimit të dashurisë së Jezusit tek ata persona që janë jashtë besimit.
8. **Administrim dhe llogaridhënie të urtë.** Kisha e shëndetshme përdor ndërtesa, pajisje, dhe sisteme të përshtatshme për të siguruar mbështetjen maksimale për rritjen dhe zhvillimin e shërbesave të saj.
9. **Rrjetëzimin me trupin e Krishtit.** Kisha e shëndetshme është në kontakt me të tjerët të cilët janë në trupin e Krishtit për bashkëpunim, ndarje të burimeve, mundësi mësimi dhe kremtime të përbashkëta të adhurimit.
10. **Administrimin dhe zemërgjerësinë.** Kisha e shëndetshme i mëson anëtarët e saj se ata janë administratorë të burimeve që u janë dhënë nga Perëndia, dhe i sfidon ata që të jenë zemërgjerë e sakrifikues duke i ndarë ato me të tjerët.



STEPHEN A. MACCHIA. Rishtypur nga manuali "Si të bëhemi një kishë e shëndetshme". Përdorur me autorizim. Më shumë informacion rreth Dhjetë Karakteristikave të një Kise të Shëndetshme gjeni tek faqja e internetit: www.HealthyChurch.net/

për Gratë
në Shërbesë



TË ARGËTOHEMI KUR GJËRAT JANË SERIOZE

Nga: MARCIA LEDNICKY





ezusi ishte një njeri shumë serioz. Besoj se të gjitha biem dakord për këtë. Misioni i tij tokësor ishte shprehia më e rëndësishme e planit të Perëndisë për të shpenguar njeriun e rënë. Ai erdhi të vdesë në kryq. Kjo është shumë e rëndë. Ai e dinte se do të përjetonte dhimbje dhe poshtërim të madh. E megjithatë, edhe duke qenë i vetëdijshëm për atë që do të vinte së shpejti, Zoti ynë i mrekullueshëm, shembulli ynë më i madh, jetoj një jetë e cila nuk u la në hije nga fatkeqësia dhe dëshpërimi.

Kështu, i bëjmë pyetjen vetes: Duke e ditur se me çfarë do të përballej, cila ishte baza e vërtetë për aftësinë që Jezusi kishte për të shijuar jetën? E thënë shumë thjesht, ishte GËZIMI. Të gjitha i kemi dëgjuar diskutimet që bëhen mbi ndryshimin që ekziston midis gëzimit dhe lumturisë. Në fakt është shumë e thjeshtë. Gëzimi është produkti i marrëdhënies sonë personale me Krishtin. Gëzimi nuk është i varur tek rrethanat e jashtme. Ndërsa lumturia, nga ana tjetër, është rezultati i disa ngjarjeve të veçanta që ndodhin në një mënyrë të caktuar.

Mund t'i drejtojmë sytë nga Fjala e Perëndisë për të na dhënë mprehtësi të mendjes në lidhje me gëzimin që Jezusi kishte dhe dëshironte që edhe ne, si motrat e tij frymërore, të kishim. Tek 1 Kronikave 16:8-10 shkruhet: *"Kremtoni Zotin, kujtoni emrin e tij; bëjini të njohura veprat e tij midis popujve. Këndojini atij, lëvdoheni, mendoni të gjitha mrekullitë e tij. Lëvdohuni me emrin e tij të shenjtë; u gëzofshin zemrat e të gjithë atyre që kërkojnë Zotin!"*. Shohim që gëzimi i vërtetë dhe liria nga ankthi varen nga **besimi** që ne kemi tek Perëndia. Jeta jonë personale e lutjes, si dhe mirënjohja ndaj Perëndisë për gjithçka që ai ka bërë, më e madhja prej të cilave është vdekja e Krishtit në kryq për shpëtimin tonë, është një shprehje e mrekullueshme e gëzimit të brendshëm. Mendoni për këtë: për shkak se Jezusi na do aq shumë, ai erdhi vullnetarisht për të dhënë jetën e tij për mua që të siguronte një mënyrë për mua që të kisha jetën e përjetshme. Kjo ndjenjë e asaj dashurie të lavdishme duhet të sjellë në secilën

prej nesh një ndjesi të madhe gëzimi, madje edhe në "kohët e seriozitetit".

Të dashura gra, gëzimi i Zotit i mbushtë zemrat tuaja deri në tejmbushje, edhe kur detyra që keni është e vështirë, edhe kur shfaqen probleme fizike, madje edhe kur bota rreth e qark jush mund të duket sikur po shembet. Zemra juaj mund të gëzojë nga njohuria, duke e ditur se jeni blerë me një çmim. Shpagimi juaj është i sigurt, dhe e ardhmja juaj është në duart e një Perëndie të dashur.



"E keni parë gjë pastorin? Para një ore doli për t'ju thënë të nxitoni me punën..!?"

Tani, le ta shohim këtë nga perspektiva e disa përvojave jetësore shumë praktike.

1. Jezusi shkoi në një dasmë (Gjoni 2:1-2). Dasmat e hebrenjve nuk zgjasnin vetëm një orë. Ato ishin shumë më të gjata, zakonisht deri në shtatë ditë. Dasmat janë të mbushura me emocione dhe argëtim, pra, një kohë ku ka shumë të qeshura dhe shumë kënaqësi. Është mirë të festohet plani që Perëndia vendosi për një burrë dhe një grua.

Nëpër dasma mund të ndodhin edhe gjëra gazmore. Më kujtohet një dasmë ku pastori që po drejtonte ceremoninë i kërkoi çiftit që të “shtërëgonin duart me njëri-tjetrin”, ndërsa ata menduan se ai u tha të “trokisnin duart”. Dhe kështu, ata panë shoqi-shoqin në sy, ngritën supet dhe filluan të duartrokisnin. Pastori, duke mos ditur çfarë të bënte, filloi të duartrokiste edhe ai, dhe në fund, të gjithë të pranishmit u bashkuan me duartrokitjet e tyre. Më pas, pastori thjesht vazhdoi më tej me ceremoninë.

2. Jezusi gjithashtu darkoi shpeshherë me miqtë, duke shijuar kohë të shkëlqyera miqësie dhe bashkëbisedimi. Miqtë janë shumë të rëndësishëm dhe krijimi i miqësive që zgjasin, kërkon kohë. Ndërtimi i marrëdhënieve kuptimplota është një investim tek të tjerët. Kjo është shumë e rëndësishme për një grua që është në shërbesë. Kjo është domethënëse në mesin e anëtarëve të familjes së kishës sonë, por ndoshta edhe më e rëndësishme në “tregun e punës”. Shumë njerëz jetojnë në rrethana jashtëzakonisht të vështira, të cilët nuk e kuptojnë se çfarë do të thotë realisht të njohësh Jezusin. Ata kanë nevojë të bien në kontakt me njerëz të Perëndisë, të cilët e kanë përjetuar personalisht gëzimin e Zotit. Ajo është e dukshme në fytyrat e tyre, në qëndrimin e tyre dhe me anë të veprave të tyre.

Më kujtohet diçka që më ka ndodhur para shumë vitesh, kur isha në shkollë biblike. Asokohe punoja në një kompani sigurimesh që bënte verifikimet e hipotekave, dhe një ditë, burri për të cilin punoja, po më shikonte dhe më tha: “Kam pasur edhe njerëz të tjerë nga shkolla jote që kanë punuar për mua, por ti je ndryshe. Je gjithmonë kaq e gëzueshme dhe e lumtur dhe përherë e qeshur dhe buzagaz”. Rri dhe e mendoj atë përvojë dhe i jam falënderuese Jezusit që më dha mundësinë ta lejoja dritën e Tij që ishte në mua e që të shkëlqente tek të tjerët. Në ato kohë, gjërat ishin goxha të vështira. Unë isha e martuar,



*Ne kemi
gjithmonë diçka
për të cilën të
jemi të gëzuara
sepse Jezusi
është gëzimi ynë,
dhe madje edhe
rrethanat më të
vështira nuk
mund të na e
largojnë atë.*

punoja dhe studioja. Kishim vetëm disa muaj të martuar, dhe bashkëshorti im gjithashtu ishte student dhe punonte. Financat mezi na dilnin për të përballuar detyrimet që kishim, dhe koha që arrinim të shpenzonim me njëri-tjetrin ishte shumë e kufizuar. Megjithatë, gëzimi i Zotit ishte gjithmonë aty.

Unë shpeshherë kam thënë: “Jobesimtarja nuk dëshiron të shkëmbejë depresionin e saj me depresionin tim”. Ne duhet të jemi në gjendje të ofrojmë diçka ndryshe nga gjërat që jobesimtarët tashmë i kanë. Kur bashkëshorti im po shërbente si president i Kolegjit Qendror Biblik, unë pata një tjetër përvojë të cilën do ta kujtoj gjithmonë. Isha në bibliotekë duke marrë hua një libër, kur në atë çast studenti që punonte në bibliotekë më tha: “Znj. Ledniki, e kam pasur shumë të vështirë me ju disa herë, dhe ndonjëherë ende vazhdon ta kem”. Tani, një koment i tillë me siguri që ndikon tek kushdo. Dhe i thashë: “Më vjen shumë keq. A ju kam bërë diçka juve që ju bën të ndiheni kështu?”, të cilës ai iu përgjigj: “Jo, po thjesht ju jeni gjithmonë duke buzëqeshur. Dhe nuk mund të jeni e çiltër dhe të buzëqeshni përherë”. Atë mbrëmje i kushtova atij komenti pak kohë për t’u menduar. Ditën tjetër, shkova përsëri tek ai dhe i thashë: “Ajo që më thatë dje më ka shqetësuar me të vërtetë, jo për shkak se m’i thatë ato gjëra, por sepse nëse ju kam dhënë përshtypjen se unë nuk kam kurrë probleme, atëherë nuk kam qenë e drejtë me ju, sepse në fakt kam edhe unë vështirësi. Por unë thjesht di burimin e forcës sime”.

Vetëm disa javë më vonë mora lajmin se nëna ime ishte diagnostikuar me një lloj shumë të rëndë kanceri. Shkova në kompleksin e universitetit, sepse kjo ishte familja ime frymërore; pashë Kentin dhe i thashë: “Kent, sot nuk jam në terezi dhe është një ditë e vështirë për mua, por unë nuk do të qëndroj me këto emocione negative, sepse unë e di nga më vjen forca ime”. Mbani mend, Jezusi është forca jonë në çdo situatë të jetës. Ne ruajmë gëzimin e Tij në zemrat tona, edhe pse në atë moment rrethanat nuk na bëjnë të lumtura.

Jezusi u tha dishepujve të Tij që të pushonin. Tek Marku 6:30-31 na thuhet se kur apostujt u takuan me Jezusin dhe i treguan Atij të gjitha gjërat e lavdishme që kishin ndodhur, Mjeshtri u tha: “*Ejani veçmas në një vend të vetmuar dhe pushoni pak*”. Ata madje nuk kishin pasur as kohë që të hanin, për shkak se kishte shumë njerëz që vinin e iknin. Jezusi e dinte sa e rëndësishme ishte që ata të largoheshin për njëfarë kohe nga presioni. Kur jeni plotësisht të rraskapitura dhe keni dhënë kaq shumë energji dhe

emocione nga vetja juaj, atëherë këto fjalë të Jezusit duket se kanë një domethënie të veçantë, dhe do të bënim shumë mirë që të ndiqnim udhëzimin e Zotit tonë. Në thelb, Jezusi tha që do të ketë gjithmonë nevoja njerëzore, por si individë, jemi të kufizuar për sasinë e punës që bëjmë. Në qoftë se gjejmë kohë për të pushuar, për një pushim rifreskues, të lehtë e të mbushur me argëtim, atëherë do të jemi pajisur më së miri për të qenë të gjindshëm për të tjerët dhe për të ofruar ndihmë frymërore. Si mendjet, ashtu edhe trupat tanë kërkojnë që të jenë të dobishëm në shërbim të Tij. A e lë kjo në hije seriozitetin e asaj që Perëndia na ka thirrur të bëjmë? Absolutisht që jo! Por, jeta është reale. Askush nuk është i përjashtuar nga gjithë ato ulje e ngritje të jetës. Mesazhi ynë nuk është një mesazh dëshpërimi dhe mallkimi. Jezusi erdhi që ne të kemi “jetë me bollëk”. Dëshmia më e mirë është një frymë e gëzueshme.

Më kujtohet teksa ishim ulur në hapësirat e për-bashkëta të mensës në kolegji kur një student erdhi tek bashkëshorti im dhe i bëri atij një pyetje të cilën nuk ia kishin bërë kurrë më parë. Ai i tha: “Në qoftë se do të kishit vetëm një fjalë për të përshkruar bashkëshorten tuaj përpara se të martoheshit, cila do të ishte ajo?”. Unë nuk e imagjinoja dot se çfarë do të thoshte bashkëshorti im. Në fakt, isha shumë e interesuar të dëgjoja përgjigjen e tij. Ai mendoi për pak dhe më në fund i tha: “Zbavitëse”. Nuk ishte edhe aq keq si përgjigje. Madje mund të shtoj se gjithmonë kam dëshiruar që shtëpia jonë të ishte një shtëpi e mbushur me zbavitje, me gëzim dhe me të qeshura.

Në ngjarjet që tregohen tek Zanafilla 21, Perëndia e mbajti fjalën e dhënë dhe bëri për Sarën atë që kishte premtuar. Ajo mbeti shtatzënë dhe lindi djalin e saj në një moshë të vjetër. E kënaqur, Sara shpalli: “*Perëndia më ka dhënë çka duhet për të qeshur; kushdo që do ta dëgjojë, ka për të qeshur bashkë me mua*” (Zanafilla 21:6).

Kapitulli 31 tek Fjalët e Urta flet për gruan me karakter të fisshëm. Në fakt, ndërsa e lexoj këtë kapitull, filloj të ndihem paksa e impresionuar. Kjo grua mund të bëjë gjithçka. Ajo është e zellshme, një kuzhinierë e mirë, një organizatore, është besnike, një biznesmene e zonja, kopshtare, plot me energji, një rrobaqepëse, e mban shtëpinë në rregull dhe vishet bukur. Ajo është e mbushur me forcë dhe dinjitet, e sjellshme dhe e urtë. Unë lodhem vetëm duke menduar për të gjitha cilësitë e saj të mrekullueshme. Megjithatë, le të mos e anashkalojmë vargun 25 ku thuhet “[ajo] qesh për ditët që do të

vijnë.” Kjo është një pjesë e përshkrimit të kësaj gruaje të jashtëzakonshme. Ajo qesh. Madje edhe me gjithë ngarkesën e saj të përditshme, ajo qëndron e gëzueshme.

Në qoftë se do të ishit në një vend me dy gra të tjera, përveç vetes, dhe njëra dukej sikur ishte gjithmonë e depresionuar, e palumtur, që nuk i qeshte buza kurrë, ndërsa tjetra dukej sikur gjithmonë kishte një zemër të gëzueshme, shihte anën pozitive të një situatë dhe shfaqte një natyrë të lumtur, me cilën nga ato do të dëshironit të shpenzonit kohë? Fjalët e Urta 17:22 thotë: *“Një zemër e gëzuar është një ilaç i mirë, por një frymë e dërrmuar i than kockat.”* Është një thënie që thotë: Në rast se do të kishit një gotë të mbushur deri në gjysmë, si do ta shihnit atë? A do ta shihnit si një gotë që ishte gjysmë e mbushur apo si një gotë që ishte gjysmë e zbrazur? Unë zgjedh ta shoh gotën si gjysmë të mbushur. Nesër ajo mund të jetë e mbushur plot. Kam opsionin për të zgjedhur se si do të përballem me jetën. Kur Jezusi të më marrë nga kjo botë që të jetoj me Të në shtëpi, lutem që kur njerëzit të mundohen të më përfytyrojnë në mendjet e tyre, të shohin një fytyrë të lumtur, të buzëqeshur dhe të kujtojnë herët e shumta që më kanë dëgjuar të qesh me gëzim të madh.

Mbani mend se kush jeni në Krishtin Jezus. Mbani mend dashurinë që Ai ka për ju, duke shkuar vullnetarisht në kryq. Mbani mend sigurinë e të ardhmes suaj me Të. Rezultati i natyrshëm është që jeta juaj e përditshme do të mbushet me një gëzim të bollshëm. Një zemër e lumtur që është plot gëzim dhe shpërthen me të qeshura është e bazuar tek Shkrimi.

Tek Psalmi 9:1, 2 thuhet: *“Unë do të të kremtoj, o Zot, me gjithë zemër, do të tregoj tërë mrekullitë e tua. Unë do të gëzohem dhe do të kënaqem me ty; do t’i këndoj lëvdime emrit tënd, o Shumë i Larti.”*

Psalmi 28:7, *“Zoti është forca ime dhe mburoja ime; zemra ime ka pasur besim tek ai dhe unë u ndihmova; prandaj zemra ime ngazëllen dhe unë do ta kremtoj këtë me këngën time.”*

Fjalët e Urta 15:15, *“Të gjitha ditët e të varfrit janë të këqija, por për një zemër të kënaqur ka festë përherë.”*

Faktikisht, ka shumë referenca nga Bibla në lidhje me të qenit plot gëzim dhe të jetuarit një jetë të

lumtur. Edhe njëherë, më lejoni të them se unë besoj që populli i Perëndisë duhet të jenë njerëzit më të lumtur në të gjithë botën. Po madje, edhe në kohë serioziteti, për shkak se gëzimi dhe lumturia jonë nuk është e ndërtuar mbi rrethanat e momentit, por mbi marrëdhënien që kemi me Zotin dhe shpëtimtarin tonë të mrekullueshëm.

Që të mos kemi ndonjë keqkuptim, unë jam plotësisht e vetëdijshme se asnjë individ nuk mund të jetë me pamje të gëzueshme në çdo minutë të ditës, prandaj mos u shkurajoni kur të keni disa nga këto kohë “sfiduese”. Thjesht mbani mend se nga vjen gëzimi juaj. Për të cituar vargjet e një kënge të shkurtër që e kam kënduar vite e vite më parë: *“Unë kam gëzimin, gëzimin, gëzimin, gëzimin në zemrën time; që të qëndrojë, të qëndrojë në zemrën time”*. Ndërsa jetojmë në hirin e Tij dhe shijojmë çdo ditë bekime kaq të bollshme, atëherë ky gëzim, në mënyrë të pashmangshme, do ta gjejë rrugën nga zemra juaj për tek fytyra juaj. Shkëlqeftë në ju dhe përmes jush dashuria dhe gëzimi i Zotit sot dhe përjetë.

Bëni diçka zbavitëse sot, diçka që do ta mbushë shtëpinë tuaj me të qeshura. Jepini një buzëqeshje kujt do që takoni. Kjo është një ditë e mirë dhe unë zgjedh të gëzohem dhe të ngazëllej në të.



Unë jam Marcia dhe ju përshëndes deri herën e ardhshme të dashura gra, dhe po ju dërgoj një buzëqeshje të madhe të dashurisë së Tij për ju. Perëndia ju bekoftë me një gëzim shumë të veçantë!

MARCIA LEDNICKY, është një folëse e shpeshtë nëpër seminare dhe konferenca për femra. Ajo ka një aftësi unike për t’i lidhur sfidat e jetës së përditshme me të vërtetat e Shkrimit. Shërbesa e saj e të folurit në publik rritet me anë të talentit të saj vokali të jashtëzakonshëm përmes të cilit ajo komunikon dhe transmeton dashurinë e Krishtit.



10 PARIMET E MBJELLJES

Nga: RICK THOMAS

Shumë prej problemeve të mëdha me të cilat përballlet bota jonë, vijnë si rezultat i dështimit në administrim. Nuk e kemi marrë seriozisht atë që Perëndia na ka dhënë, ose nuk e kem përdorur ashtu siç duhet.

Kur Perëndia krijoi botën, dhe formoi burrin dhe gruan, ai i bekoji ata dhe iu tha: “Të jeni të frytshëm dhe shumëzohuni, mbushni tokën e nënshtrojeni, e sundoni mbi peshqit e detit, mbi zogjtë e qiellit dhe mbi çdo qenie që lëviz mbi tokë.” (Zanafilla 1:28). Cili ka qenë rezultati i këtij *sundimi*? Miliona njerëz kanë jetuar dhe kanë vuajtur përmes luftërave, urisë dhe varfërisë.

Si individë, ne kemi abuzuar me përgjegjësinë tonë duke mbjellë në mish, në vend që të mbillnim në frymë, dhe pastaj kemi pyetur veten si ka mundësi që çdo gjë është kaq mbrapsht e rrëmuje. Më mahniti fakti që njerëzit duan gjithçka që Perëndia dëshiron që t'iu ofrojë, por megjithatë nuk duan të jetojnë sipas besëlidhjeve të Tij. Më mirë e kanë të zukasin këngën e Frenk Sinatra "I did it my way" që do të thotë: "e bëra sipas mënyrës sime".

Që prej foltores, i kam pyetur:

– "Sa prej jush e doni dorën e Perëndisë në jetët tuaja?"

"Çdo besimtar përgjigjet: „Po, o Zot!”

– "Sa prej jush doni që Fryma e Perëndisë të jetë e pranishme në mënyrë madhështore?"

– "Amen!"

– "Sa prej jush doni shenja dhe mrekulli që të rrjedhin përmes jush?"

– "Po, po!"

– "Sa prej jush doni që bekimet e Perëndisë të shfaqen fizikisht dhe në mënyrë të prekshme?"

– "Po, o Zot!"

– "Sa prej jush janë të gatshëm të jetojnë me shenjtëri dhe drejtësi përpara Perëndisë?"

– "Ta mendojmë njëherë, o Zot".

Ata hezitojnë dhe nuk janë të gatshëm të marrin masa rreth asaj që është realisht çelësi për të korrën e tyre. Bibla shpall: "*Sepse Zoti Perëndi është diell dhe mburojë; Zoti do të japë hir dhe lavdi; ai nuk u refuzon asnjë të mirë atyre që ecin drejt.*" (Psalmi 84:11).

Ne të gjithë dëshirojmë të marrim pjesë në tavolinën e gostisë, e megjithatë Perëndia vazhdon të pyesë: "Çfarë keni bërë me atë që ju kam dhënë? Si po e mbillni farën tuaj?"

Më lejoni të ndaj këto dhjetë parime të mbjelljes:

1) KOHA E MBJELLJES DHE E KORRA DUHET TË KTHEHEN NË NJË STIL JETESË.

Kjo nuk është diçka që ju e praktikoni me raste si një përpjekje për ta bërë Zotin që të bekojë një sipër-marrje tregtare apo një anëtar të familjes suaj. Ajo duhet të jetë një mënyrë absolute jetese 24 orë në ditë, 7 ditë të javës, e cila përfshin gjithçka që bëni.

Në të natyrshmen, çdo lëvizje që bëjmë, prodhon njëfarë reagimi. Sipas Ligjit të Tretë të Lëvizjes të Njutonit, për secilin veprim ekziston një kundërveprim i barabartë dhe i kundërt me të.

Ligji i të korrave i Perëndisë do të jetë në fuqi derisa të mbetet ende kohë.

Për këtë arsye duhet të lëvizim drejt ritmit dhe modelit të mbjelljes së farës së mirë, duke e ushqyer bimën dhe duke vjelë rezultatet. Ky duhet të bëhet një nënprodukt automatik i administrimit dhe i stilit tonë të jetesës.

2) ÇDO FJALË QË THONI ËSHTË NJË FARË E MBJELLË.

Ajo që rrjedh prej gojës suaj, jo vetëm që zbulon përmbajtjen e zemrës suaj, por përcakton edhe orientimin e jetës suaj. Fjalët tona mund të ndihmojnë ose të pengojnë, të bekojnë ose të mallkojnë, të shërojnë ose të lëndojnë dhe, sipas Fjalës: "*Vdekja dhe jeta janë nën pushtetin e gjuhës*" (Fjalët e Urta 18:21).

Besoj se e kuptoni që ajo çfarë po bëni sot është si rrjedhojë e drejtpërdrejtë e fjalëve që nxorët nga goja dje, muajin e kaluar apo vite më parë. Kjo është ajo që Zoti vuri në lëvizje që prej fillimit, pra, Ai *foli*, dhe bota u krijua.

Perëndia na dha të sundonim jo vetëm botën, por edhe gjuhën tonë!

Sot, ndërkohë që ne po flasim me drejtësi, besim dhe nën frymëzimin e Frymës së Shenjtë, atëherë jemi duke mbjellë atë lloj fare të cilën Perëndia e bekon.

3) DUHET TË JENI VAZHDIMISHT DUKE PRITUR TË KORRAT.

Kam takuar njerëz që thonë se presin të korrin, e megjithatë nuk e demonstrojnë aspak këtë gjë. Kur diçka fatkeqe u ndodh, ata përgjigjen: "E dija që do më ndodhte diçka e tillë!". Është e dukshme që ata po prisnin të korrat e gabuara!

Mik i dashur, çdo gjë negative duhet të konsiderohet jo normale. Në shkollën fillore mësova se në qoftë se do t'iu gjuaja shokut të klasës, kishte mundësi që edhe ai të ma kthente gjuajtjen mbrapsht. Pra, përsëri, është ligji i veprimit dhe i kundërveprimit. Kështu, m'u desh që të përcaktoja se ç'lloj farërash do të përdorja për të pasur avantazh mbi fëmijët që ishin më të mëdhenj se unë.

Ne duhet të "shohim" rezultatet që dëshirojmë, dhe të llogarisim koston që duhet për t'i marrë ato rezultate. Filloni të shihni! "*A nuk thoni ju se ka edhe katër muaj dhe vjen korrja? Ja, unë ju them: Ngrini sytë tuaj dhe shikoni fushat, sepse ato janë tashmë të bardha për korrjen.*" (Gjoni 4:35).

4) PRANONI SE LIGJI I TË KORRAVE ËSHTË E VËRTETA E PERËNDISË DHE JO E JUAJA.

Disave iu pëlqen t'i bëjnë vetë rregullat për marrjen e bekimit të Zotit. Ata duan të përzgjedhin llojin e farës,

gjendjen e arës dhe madje edhe orarin e mbjelljes dhe vaditjes. Pastaj, kur dështojnë dhe nuk arrijnë që të marrin rezultatet e pritura, murmurisin e ankohen. Ka ardhur koha të pranojmë faktin se nuk po jetojmë në tokën tonë, por në atë të Perëndisë. Atij i përket edhe ara, edhe prodhimi.

Mënyra më e mirë për të mbjellë është ta fillojmë duke rënë në gjunjë, në kuptimin e parë të fjalës. Kërkoni në lutje drejtimin e Perëndisë përpara se të hapni dheun dhe të vendosni farën e vogël në të. I vetmi "Kalendar i Bujkut" që do t'ju nevojitet, është Bibla. Aty shpaloset *çfarë duhet, koha, vendi dhe mënyra* e mbjelljes.

5) FILLONI QË TA MBILLNI FARËN TUAJ ATY KU JENI.

Të gjithë i kemi dëgjuar këto justifikime:

- "Një nga këto ditë do t'ia filloj që të kursej për të ardhmen".
- "E di që duhet të jap mësim tek grupi i fëmijëve në kishë, por jam shumë i zënë këtë vit".
- "Kam një kushëri të cilit do të doja shumë që dikush t'i fliste për Zotin".

A e duam me të vërtetë një të korrë? Nëse "po", atëherë duhet t'ia fillojmë këtu, dhe *tani!* Nuk mund të presim derisa çdo gjë të jetë në rregull dhe derisa kushtet të jenë të përsosura. Në rast se po i besoni Perëndisë që t'ju bekojë financiarisht, por megjithatë nuk keni para për të mbjellë, filloni me diçka që është me vlerë për ju. Nëse po luteni që Zoti të prekë jetën e një mikut tuaj, vendosni që të jeni ju instrumenti të cilin Zoti do ta përdorë. Nëse besoni se Perëndia iu përgjigjet lutjeve, filloni të luteni. Filloni aty ku jeni. "Ja, tani, është koha e pëlqyer" (2 Korintasve 6:2).

6) KUPTONI QË JU ËSHTË PREMTUAR NJË E KORRË.

Kam një pyetje këtu të cilën dëshiroj që ta bluani pak në kokë: Çfarë do të bënit në rast se do ta dinit që nuk mund të dështoni? A do të hapnit një biznes të ri, apo do të vendosnit të bëheshit një këngëtar? A do të fillonit një shërbesë? Kur m'u bë mua e njëjta pyetje, unë u përgjigja: "Unë do të isha besnik me çfarëdo gjëje që do të më kapnin duart, duke e ditur që ajo do të lulëzonte".

Por kjo është më shumë sesa një supozim. Kur ju ecni në vullnetin e Perëndisë dhe mbillni farën që Ai ka zgjedhur, nuk mund të dështoni. Ai premtun një kohë për të korrur për aq kohë "derisa të jetë toka" (Zanafilla 8:22).

Në qoftë se jeni besnikë me mbjelljen e farës, Zoti është besnik në dhënien e të korrës.

Bibla shpall:

"Sepse Zoti Perëndi është diell dhe mburojë; Zoti do të japë hir dhe lavdi; ai nuk u refuzon asnjë të mirë atyre që ecin drejt." (Psalmi 84:11).

Ne të gjithë dëshirojmë të marrim pjesë në tavolinën e gostisë, e megjithatë Perëndia vazhdon të pyesë: "Çfarë keni bërë me atë që ju kam dhënë? Si po e mbillni farën tuaj?".





7) NE RAST SE PRODHIMI JUAJ DESHTON KËRKOJINI NDIHMË PERËNDISË QË TË FILLONI PËRSËRI.

Si besimtarë, ne të gjithë gabojmë, por kjo nuk do të thotë që s'duhet të lexojmë më Biblën dhe ta braktisim kishën. Zoti na lejon që t'ia fillojmë përsëri.

E mbani mend Jonan? Perëndia i tha atij që të mbillte Fjalën në qytetin e Ninivesë. Megjithatë, ai u rebelua dhe u nis për në qytetin e Tarshishit. Pasi e hodhën në det nga anija dhe pasi u gëlltit nga një balenë, atëherë i erdhën mendtë këtij shërbëtori të Perëndisë. Dhe pikërisht atëherë peshku pati probleme me tretjen dhe e hodhi atë në breg. *"Fjala e Zotit iu drejtua Jonas për herë të dytë, duke thënë: „Çohu, shko në Ninive, qyteti i madh, dhe shpalli atij mesazhin që po të urdhëroj”* (Jona 3:1-2). Perëndia i dha atij një shans të dytë.

E njëjta gjë i ndodhi edhe Pjetrit, i cili u kthye në personifikimin e një dështimi tragjik kur e mohoi Zotin publikisht. E megjithatë, pas ringjalljes, Jezusi e kërkoi dhe erdhi që të takojë pikërisht Pjetrin të parin. Ai u fal dhe filloi të mbjellë ungjillin në jetët e mijëra njerëzve.

8) PRANONI SE KOHA E MBJELLJES DHE E KORRA ËSHTË BËRË PËR TË MIRËN TUAJ.

Premtimi i Perëndisë nuk është për dikë tjetër; ai është për ju. Vetëm për shkak se stina juaj e bollëkut frymëror s'ka ardhur, nuk do të thotë se nuk do të vijë kurrë. Është gjë e mirë të besoni se Zoti do t'ju sjellë një të korrë, sepse është një "parim i Perëndisë" i cili është vënë në lëvizje. Duhet të besoni në Të dhe për Të! Ati juaj qiellor thotë: *"Jepni dhe do t'ju jepet"* (Luka 6:38). Ky është një premtim hyjnor.

9) BESONI SE PERËNDIA DO TA SHUMËZOJË ATË QË JU KENI DHËNË.

Kur shtrëngoni një farë të vogël në dorën tuaj, ajo mund të rrëshqasë lehtësisht përmes gishtave, por provoni ta mbillni dhe ta ujisni atë në një tokë pjellore dhe pastaj shiheni se ç'do të ndodhë. Ajo zhvillon një jetë më vete. Ajo farë e vetme fillon të shumëfishohet, duke ju dhënë ushqim për të ngrënë dhe teprica të mjaftueshme sa të mbillni të mbjella edhe më të mëdha.

Fjala e Perëndisë shpall: *"Por ai që i jep farën mbjellësit dhe bukën për të ngrënë, ju dhëntë dhe i shumoftë të mbjellat tuaja, dhe bëftë që të rriten frytet e drejtësisë suaj"* (2 Korintasve 9:10). Zoti nuk shton, ai shumëfishon!

10) KUPTONI SE KOHA E MBJELLJES DHE E KORRA BAZOHEN NË STINË TË VEÇANTA.

Mbas përmbytjes, Perëndia vendosi stinën e dimrit, të pranverës, të verës dhe të vjeshtës për çdo vit, dhe ky rend i stinëve nuk ka ndryshuar kurrë. Ekziston një kohë e caktuar për të mbjellë dhe një kohë për të korrur. Asnjë bujk nuk do ta mbillte farën në tokë një ditë dhe të kthehej të nesërmen duke kërkuar: "Ku e kam prodhimin?". Jo, ai pret deri në stinën e të korrave.

Jozefi, kur ishte një djalë i vogël, pa një ëndërr se një ditë ai do të bëhej një udhëheqës. Madje edhe pasi u shit si skllav dhe u dërgua në Egjipt, ai priti me durim derisa të vinte momenti kur vegimi i tij të bëhej realitet. Dhe kjo ndodhi jo në kohën e Jozefit, por në kohën e Perëndisë!

E KORRA E ARDHSHME

Çfarë administratori kemi qenë ne me farën që Perëndia ka vendosur në duart tona? A është shpërndarë apo është mbjellë, është çuar dëm apo është vaditur, është shkatërruar apo është korrur? Një ditë, së shpejti, të gjithë do të japim llogari për ato që kemi bërë në jetë. Në të korrën e fundit, unë dëshiroj të dëgjoj Atin tim të më thotë: "Të lumtë!".

Ky artikull është marrë nga *Significant Seed – Perpetual Harvest* [Farë e Rëndësishme – E Korrë e Përjetshme] ©2005 nga Rick Thomas. Përdorur me lejen e autorit. Të gjitha të drejtat të rezervuara.



RICK THOMAS, është pastor kryesor i Qendrës së Krishterë Jetë me Bollëk në Margeit, Florida. Ai është një pastor-mësues dhe folës konferencash i njohur në rang ndërkombëtar.

IMPACT MONTENEGRO

Nga: KURT D. PLAGENHOEF

Në

datat 2 – 9 korrik, rreth 150 njerëz nga 11 vende evropiane dhe nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës u mbledhën bashkë për të ndikuar kombin e Malit të Zi me ungjillin e Krishtit.

Ky vend ballkanik me një popullësi prej rreth 600 mijë banorësh është vendi më pak i arritur me ungjillin në Evropë. Në Mal të Zi gjenden vetëm rreth 150 besimtarë ungjillorë, dhe nga këta, pothuajse 25 prej tyre janë malazezë. Ne e kuptojmë se Perëndia na ka thirrur për ta arritur me lajmin e mirë të Jezusit këtë vend të varfër nga ana frymërore!


Fushata ungjillëzuese **IMPACT MONTENEGRO** u organizua nga Bashkësia Evropiane Pentekostale (BEF). Një sërë udhëheqësish të BEF-it mbajtën fjalime në sesione trajnimi mjaft frymëzuese. Fushata e ungjillëzimit u përkufizua nga udhëheqësit vendorë si një përvojë historike, duke i afruar këta udhëheqës në unitet për të arritur qytetet e tyre.

E filluam këtë kohë ungjillëzimi në Podgoricë, kryeqytetin e Malit të Zi, me një kohë lutjeje dhe trajnimi dhe më pas u përhapëm në shtatë qytete të ndryshme: Podgoricë, Tuz, Nikshiq, Bar, Budva, Kotorr dhe Ulqin. Kishim me vete një grup të mrekullueshëm prej 34 njerëzish nga Asambleja e Perëndisë në Shqipëri. Grupi ynë shqiptar u nda në dy skuadra duke u shërbyer shqiptarëve në Ulqin dhe Tuz. Shumë prej njerëzve me të cilët folëm nuk e kishin dëgjuar kurrë ungjillin dhe nuk kishin takuar kurrë një të krishterë ungjillor.

Në Ulqin, një qytet i bukur buzë detit Adriatik, punuam së bashku me misionaren Bukurie Nikqi si dhe me një skuadër nga Kosova. Bëmë ecje në lutje përmes qytetit, duke ndërmjetësuar për një derdhje të Frymës së Shenjtë, që njerëzit të kishin një zbulesë të Jezu Krishtit si dhe për themelimin e një kisha. Në mbrëmje, shkuam buzë detit dhe dhamë shfaqje me dramë, muzikë dhe kllounë. Skuadra u angazhua në mënyrë aktive me shpërndarjen e literaturës, vizatime të fytyrës si dhe me ungjillëzim tek e tek. Shumë njerëz u tërhoqën nga drita, dashuria dhe gëzimi i besimtarëve, duke na lejuar të flasim me ta dhe të lutemi për ta.

Unë vetë u preka nga disa prej bisedave domethënëse që pata:

- Takova Islamin, një burrë nga Ulqini, i cili jeton në Amerikë, por e shpenzon çdo verë në shtëpinë e tij në Ulqin së bashku me fëmijët dhe nipërit dhe mbesat e tij. Folëm bashkë për një kohë të gjatë. Unë ndava ungjillin me të, lexova një pasazh nga Shkrimi dhe i dhashë atij një Dhjatë të Re. Ndërsa mbante



2017

Biblën në duar, sytë i ndritën. Ishte hera e parë për të që dëgjoi Fjalën e Perëndisë. Unë u luta për të dhe familjen e tij dhe vazhdoj t'i besoj Perëndisë që do të depërtojë dhe transformojë jetën e tij.



- Një tjetër burrë, Denisi, që ishte një pronar vendor i një biznesi, kishte ardhur nga Kosova në Mal të Zi bashkë me prindërit e tij që kur ishte foshnje. Megjithëse është rritur në Mal të Zi, ai ende ndihet si i huaj dhe të tjerët nuk e konsiderojnë atë si ulqinak. Ndërsa i dhashë literaturë ungjillëzuese dhe një Dhjatë të Re, pata mundësinë edhe të ndaja me të Krishtin dhe shpresën që na jep identiteti në Krishtin.
- Gjithashtu pata kënaqësinë të takoja Stefanin, një dritë vezulluese në Ulqin. Ai është një nga besimtarët e paktë malazezë nga Ulqini. Ai dëgjoi ungjillin dhe u shpëtua në Beograd, në një program rehabilitimi nga droga. Më pas u kthye në Ulqin ku punon dhe gjithashtu është pjesë e një kishe ungjillore në Bar. Ndërkohë që ai ndan dëshminë e tij se si Jezusi i ka ndryshuar jetën, njerëzit e dëgjojnë me respekt por pastaj kthehen dhe vazhdojnë rrugën e tyre. Stefani, në mënyrë të dëshpëruar, dëshiron që ata të njohin shpëtimtarin, dhe ai vazhdon të lutet, të dëshmojë dhe të ndjekë Krishtin pavarësisht nga vështirësitë.

Pika kulmore e javës ishte një koncert ungjillëzues në qiell të hapur natën e fundit në Podgoricë, ku me qindra njerëz patën rastin të dëgjonin ungjillin përmes muzikës, dramës, dëshmimeve dhe kontakteve personale. Të gjithë u larguam me një barrë më të madhe që të vazhdojmë të lutemi për Malin e Zi si dhe të marrim pjesë gjithashtu në fushatën ungjillëzuese të verës së ardhshme, **IMPACT KOSOVA 2018** në datat 9-15 korrik.

Ne e dimë që Perëndia ka një thirrje profetike për lëvizjen tonë të Asambleve të Perëndisë në Shqipëri për të arritur Ballkanin, dhe Mali i Zi është duke klithur që t'i vijmë në ndihmë. Ne po lutemi për punëtorë shqiptarë me afat të gjatë, të cilët janë të gatshëm të lënë shtëpitë e tyre për kauzën e Krishtit dhe të shërbejnë në një vend më pak të arritur. A do të lutemi? A do të jepni? A do të shkoni? Perëndia po kërkon ... dhe ne jemi gati të ndihmojmë për t'ju dërguar.



KOLEGJI TEOLOGJIK UNGJILLOR

*..sepse Perëndia i të korrave vazhdon
të thërrasë punëtorë!*



**Pastor, a keni nevojë që të zhvilloni
bashkëpunëtorë frymërorë dhe të aftësuar në
kishën tuaj? Lejoni që KTU të ndihmojë!
KTU ekziston që...**

- të përgatisë mbjellës kishash, pastorë, misionarë dhe shërbëtarë të tjerë me dijen e Fjalës së Perëndisë dhe një shërbesë të efektshme në një kontekst pentakostal
- të mësojë teologji të shëndoshë dhe të zhvillojë udhëheqës shërbëtorë
- të avancojë ungjillin dhe të themelojë kisha pentakostale dhe të tjera ungjillore midis shqiptarëve dhe më gjerë në të tërë botën

...dhe është duke e përmbushur këtë qëllim. Pas dhjetë vitesh investimi në përgatitjen e shërbyesve, jemi duke parë frute. Pesëdhjetë të diplomuar janë duke ndikuar për Krishtin në shumë vende të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë dhe në kombe të tjera jashtë vendit.

Në KTU, studentët do të mësojnë rëndësinë e formimit transformues të karakterit, të jetës së krishterë në komunitet, doktrinës së shëndo-shë, mësimi të mirë biblik, teologjik, misiologjik, si dhe përgatitjes së balancuar dhe serioze për shërbesë. KTU nuk është një shkollë dishepullizimi për besimtarë të rinj. Kjo është një shkollë biblike e një niveli universitar për ata që janë të thirrur për shërbesë.

Dërgimi i një studenti në KTU kërkon besim, përkushtim dhe sakrificë, por ju garantojmë që ia vlen të investosh. A dëshironi që shërbesa juaj të rritet? Atëherë mbillen farën në trainim. Një drejtues-misionar ka thënë, *"Ai që trainon më shumë, korr më shumë shpirtëra të humbur."* Bëni një hap besimi dhe do të shikoni çfarë Perëndia do të bëjë!

Për më shumë informacion, kontaktoni:

ktu@icc-al.org ♦ Cel.: 069 406 8956